REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Nr. 8582/76, datë 28.10.2015

# VENDIM

**Nr. 865, datë 21.10.2015**

## PËR

## MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK "PËR ETIKETIMIN E ENERGJISË PËR KONDICIONERËT E AJRIT"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.68/2012, "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**NIKO PELESHI**

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

ARBEN AHMETAJ

---

[1] *Projektvendimi është në përputhje të plotë me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, nr. 626/2011, datë 4 maj 2011 "Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit". Numri EUR-Lex-32011R32011R0626-EN. Fletore zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 178/1, e amenduar nga Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, nr. 518/2014, datë 5 mars 2014 që amendon rregulloret e lidhura*

# RREGULL TEKNIK

# PËR ETKETIMIN E ENERGJISË PËR KONDICIONERËT E AJRIT

**1. Përmbajtja dhe fusha e përdorimit**

1.1 Ky rregull teknik përcakton kërkesat për etiketimin dhe sigurimin e informacionit plotësues për kondicionerët e ajrit që funksionojnë me energji elektrike, me kapacitet nominal ≤ se 12 Kw, për ftohje ose ngrohje, nëse produkti nuk ka funksion ftohës.

1.2 Ky rregull teknik nuk zbatohet për:

a) pajisjet që nuk përdorin burime të energjisë elektrike:

b) kondicionerët e ajrit, për të cilët kondensatori ose avulluesi i tij. ose të dy, nuk përdorin ajër për transferimin e nxehtësisë mesatare.

**2. Përkufizime**

Përveç përkufizimeve të dhëna në ligjin nr.68/2012, "Për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji". zbatohen dhe përkufizimet e mëposhtme:

2.1 "Kondicioner", pajisja që mundëson ftohjen ose ngrohjen, ose të dyja bashkë, të ajrit në një mjedis të brendshëm, duke përdorur ciklin e ngjeshjes së avullit të gjeneruar nga një kompresor elektrik. Këtu përfshihen edhe kondicionerët e ajrit që ofrojnë funksione të tjera te tilla si tharje të ajrit, pastrim të ajrit. ventilim ose futje të ajrit të ngrohtë që kalon nga një rezistencë ndihmëse elektrike si dhe pajisjet që mund të përdorin ujë, (kondensati i ujit që është formuar në avullues ose uji që vjen nga një burim i jashtëm), për avullim në kondesator. me kusht që pajisja gjithashtu të mundësojë të funksionojë pa përdorim të ujit shtesë, duke përdorur vetëm ajër;

2.2 "Kondicioner me dy kalime ajri". një kondicioner, në të cilin. gjatë ftohjes ose ngrohjes. ajri në kondensator ose avullues vjen nga mjedisi i jashtëm nëpërmjet një kanali ajri dhe del në mjedisin e jashtëm nga një kanal idytë. i cili është i vendosur afër një muri në hapësirën e brendshme;

2.3 "Kondicioner me një kalim ajri", një kondicioner në të cilin. gjatë ftohjes ose ngrohjes. kondensatori ose avulluesi merr ajër nga hapësira ku ndodhet njësia dhe e shkarkon jashtë nga kjo hapësirë;

2.4 "Kapaciteti nominal" (Pnom). kapaciteti ftohës ose ngrohës i ciklit të ngjeshjes së avullit i njësisë në kushtet standarde të vlerësimit:

2.5 "Pikë shitje". vendi ku kondicionerët paraqiten ose ofrohen për shitje. qira ose blerje me këste.

2.6. "Kondicioner me kthim të ajrit". kondicioneri i ajrit që mundëson të kryejë si ftohjen ashtu dhe ngrohjen:

2.7 "Kushte standarde vlerësimi", kombinimi i temperaturave të brëndshme (Tbr) dhe të jashtme (Tj) që përshkruajnë kushtet e funksionimit dhe ndërkohë përcaktojnë nivelin e fuqisë së zhurmës, kapacitetin nominal. kapacitetin nominal te fryrjes se ajrit. shkalla nominale e efiçencës të energjisë (EERnom) dhe/ose koefiçenti nominal i performancës (COPnom). siç përcaktohen në tebelën 2 të pikës 8;

2.8 "Temperaturë e brendshme" (Tbr). temperatura e brendshme e bulbit (ose termometrit) të thatë [°C] (me lagështi relative të treguar nga temperatura korresponduese e ajrit të lagësht):

2.9 "Temperaturë e jashtme" (Tj). temperatura e jashtme e bulbit (ose termometrit) të thate [°C] (me lagështi relative të treguar nga temperatura korresponduese e aparatit matës);

2.10 "Shkalla nominale e efiçencës së energjisë" (EERnom) është kapaciteti i deklaruar për ftohje (kW termik) i pjesëtuar me fuqinë e vlerësuar nominale të inputit për ftohje [kW elektrik] i njësisë kur siguron ftohje në kushtet standarde të vlerësimit:

2.11 "Koeficenti nominal i performancës" (COPnom), kapaciteti i deklaruar për ngrohje [kW termik] i pjestuar me fuqinë e vlerësuar nominale të inputit për ngrohje [kW elektrik] i njësisë kur sigurohet ngrohje në kushtet standarde të vlerësimit;

2.12 "Potencial i ngrohjes globale" (PNG). masa e vlerësuar për të kontribuar në ngrohjen globale e një 1 kg lëndë ftohëse e përdorur në ciklin e komprimimit të avullit. e shprehur në ekuivalent kg $CO_2$ përgjatë një periudhë kohore 100 vjeçare:

2.13 "Gjendje e stakuar" është gjendja në të cilën kondicioneri i ajrit ose ventilatori është i lidhur me burimin e energjisë por nuk kryen asnjë funksion. Si gjendje e stakuar konsiderohen edhe kushtet që sigurojnë vetëm një tregim të gjendjes së stakuar, si dhe funksionalitetet e parashikuara për të siguruar përputhshmërine elektromanjetike. sipas legjislacionit në fuqi.

2.14 "Gjendje gadishmërie". gjendja ku pajisja është e lidhur me burimin kryesor të energjisë. varet nga inputi i burimit kryesor të energjisë për të punuar sipas qëllimit të parashikuar dhe siguron vetëm funksionet e mëposhtme. të cilat mund të vazhdojnë për një kohë të pacaktuar. si funksioni i riaktivizimit. ose funksioni i riaktivizimit i shoqëruar me një tregues të mundësimit të funksionit të riaktivizimit. dhe/ose informacion apo shfaqje e këtij statusi.

2.15 "Funksion riaktivizimi". funksioni që lehtëson aktivizimin e gjëndjeve të tjera. duke përfshirë gjëndjen aktive. në komandim nga distanca përfshirë telekomandën. sensorin e brendshëm. kohëmatësin me kushtin që të sigurojë një gjendje funksionale shtesë. duke përfshirë dhe funksionin kryesor.

2.16 "Informacion ose statusi i ekspozimit". një funksion i vazhdueshëm që siguron informacion ose që tregon statusin e pajisjes mbi një ekran. përfshirë dhe orën.

2.17 "Niveli i fuqisë së zhurmës". niveli i ponderuar i emetimit të tingullit [dB (A)] brenda dhe/ose jashtë. i matur në kushtet standarde të vlerësimit për ftohje (ose ngrohje nëse produkti nuk ka funksion ftohjeje):

2.18 "Kushtet referencë të projektimit". kombinimi i kërkesave për temperaturën reference të projektimit. temperaturës bivalente maksimale dhe temperaturës maksimale të operimit. siç janë dhënë në tabelën 3. të pikës 8.

2.19 "Temperatura referencë e projektimit", temperatura në ambientin e jashtëm [°C] për ftohje (Tprojft) ose për ngrohje (Tprojng) siç përshkruhet në tabelën 3, të pikës 8, në të cilën raporti i ngarkeses së pjesshme është i barabarte me 1 dhe që ndryshon sipas sezonit të ngrohjes ose të ftohjes.

2.20 "Shkalla e ngarkesës së pjesshme" (pl (Tj)), temperatura e jashtme minus 16°C, e pjestuar me temperaturën referencë të projektimit minus 16°C, si për ftohje ashtu dhe për ngrohje;

2.21 "Stinë", një nga katër stinët e operimit (një stinë për ftohjen dhe tre stinë për ngrohjen: mesatare/më e ftohtë/më e ngrohtë) që përshkruajnë për bin kombinimin e temperaturave të jashtme dhe numrin e orëve të këtyre temperaturave që ndodhin për stinën për të cilën njësia është e deklaruar si e aftë për këtë qëllim;

2.22 "Bin" (me indeksin j), kombinimi i një temperature të jashtme (Tj) dhe orët bin (hj), si jepen në Tabelën 1 të pikës.8.

2.23 "Orët bin", orët për stinë (hj) të temperaturës së jashtme që ndodh për çdo bin, si jepen në tabelën 1 të pikës 8.

2.24 "Shkalla stinore e efiçencës së energjisë" (SEER), shkalla e përgjithshme e efiçencës së energjisë së njësisë, përfaqësuese për të gjithë stinën e ftohtë, e llogaritur si kërkesa vjetore referencë për ftohje e pjestuar me konsumin vjetor të energjisë për ftohje;

2.25 "Kërkesa vjetore reference për ftohje" (QC), kërkesa reference për ftohje [kWh/vit] e përdorur si bazë për llogaritjen e SEER dhe e llogaritur si prodhim (shumëzim) i ngarkesës së projektimit për ftohje (Pproj) me orët ekuivalente të gjendjes aktive për ftohje (HCE);

2.26 "Orë ekuivalente të gjendjes aktive për ftohjen" (HCE), numri i orëve vjetore të supozuara [orë/vit] që njësia të japë ngarkesën e projektuar për ftohje (Pproj), me qëllim që të plotësohet kërkesa vjetore referencë ftohje, siç është përcaktuar në Tabelën 4 të pikës 8;

2.27 "Konsumi vjetor i energjisë elektrike për ftohje" (QCE), konsumi i energjisë elektrike [kWh/vit] i kërkuar për të plotësuar kërkesën vjetore referencë të ftohjes dhe llogaritet si kërkesë vjetore referencë për ftohje të pjestuar me shkallen stinore të efiçensës së energjisë (SEERon), dhe konsumin e energjisë elektrike të njësisë me termostat të stakuar, në gjëndje gadishmerie , të fikur dhe në mënyrën e operimit bazuar tek ngrohja gjatë stinës së ftohtë:

2.28 "Shkalla e efiçencës së energjisë në gjendjen stinore aktive" (SEERon), shkalla mesatare e efiçencës së energjisë së njësisë në gjëndjen aktive në funksionin e ftohjes, e formuar nga ngarkesa e pjesshme dhe raporti specifik bin i efiçencës së energjisë (EERbin(Tj)) dhe i ponderuar nga orët bin ku ndodhin kushtet bin:

2.29 "Ngarkesë e pjesshme", ngarkesa e ftohjes (Pft(Tj)) ose ngarkesa e ngrohjes Png(Tj)) [kW] në një temperaturë të jashtme të veçantë Tj, e llogaritur si ngarkesë e projektuar e shumëzuar me raportin e ngarkesës së pjesshme:

2.30 "Shkalla specifike e efiçensës bin të energjisë" (EERbin(Tj)), shkalla specifike e efiçensës së energjisë për çdo bin (j) në temperaturën e jashtme Tj në një stinë, i përftuar prej ngarkesës së pjesshme. shkallës së deklaruar tëefiçensës së energjisë (EERd(Tj)) për bin (j) të specifikuar dhe i përllogaritur për bin-e t ë tjerë nëpërmjet inter/ekstrapolimin, e korrigjuar nga koeficienti i degradimit kur është e nevojshme.

2.31 "Koeficenti i performancës stinore" (SCOP), koeficenti i përgjithshëm i performancës së njësisë, përfaqësues për të gjithë stinën e ngrohjes (vlera e SCOP lidhet me stinën e ngrohjes), i llogaritur si kërkesa vjetore referencë për ngrohje pjestuar me konsumin vjetor të energjisë elektrike për ngrohje;

2.32 "Kërkesa vjetore reference për ngrohjen" (QH), kërkesa referencë për ngrohje [kWorë/vit], e lidhur me stinën e ngrohjes, për t'u përdorur si bazë për llogaritjen e SCOP dhe llogaritet si prodhim/shumëzim i ngarkesës së projektuar për ngrohje (Pproj.) me orët ekuivalente aktive stinore për ngrohje (HHE);

2.33 "Orët ekuivalente aktive për ngrohje" (HHE), numri i vlerësuar i orëve në vit [orë/vit] që njësia të sigurojë në ngarkesën e projektuar për ngrohje (Pproj), me qëllim që të plotësojë kërkesën mbi kërkesën vjetore referencë për ngrohje, si jepet ne tabelen 4, të pikës 8.

2.34 "Konsumi vjetor i energjisë elektrike për ngrohje" (QHE), konsumi i energjisë elektrike [kWh/vit] i kërkuar për të plotësuar kërkesën vjetore referencë të treguar për ngrohje që përkon me stinën e ngrohjes dhe llogaritet si kerkesë vjetore referencë për ngrohje i pjesëtuar me koeficentin e performancës stinore në gjëndjen aktive (SCOPon) dhe me konsumin e energjisë të njesise me termostat të stakuar në gjëndje gadishmerie, të fikur dhe në mënyrën e operimit të bazuar tek ngrohja gjatë stinës së ngrohjes;

2.35 "Koeficienti i performancës stinore në gjendjen aktive" (SCOPon), koeficienti mesatar i performancës së njësisë në gjendjen aktive për stinën e ngrohjes, i formuar prej ngarkesës e pjesshme, kapacitetit eklektik të përafruar për ngrohje (kur kërkohet) dhe koeficientët specifikë bin të performancës (COPbin(Tj)) dhe të ponderuar nga orët bin dhe kushti i verifikuar bin;

2.36 "Kapacitetiti i ngrohësit elektrik mbështetës", kapaciteti ngrohës real ose i supozuar i një ngrohësi elektrik mbështetës me COP 1, me qëllim që të plotësohet ngarkesa e pjesshme për ngrohje (Ph(Tj)) në rastin kur Pdh(Tj) është më e vogël se Ph(Tj) për temperaturë të jashtme (Tj);

2.37 "Koeficienti bin-specifik i performancës" (COPbin(Tj)), koeficienti i performancës specifke për çdo bin j me temperaturë të jashtme Tj në çdo stinë, i përftuar nga ngarkesa e pjesshme, kapaciteti i deklaruar dhe koeficenti i deklaruar i performancës (COPd(Tj)) për bin (j), të specifikuar dhe të përllogaritur për bine të tjerë përmes inter/ekstrapolimit, e korrigjuar nga koeficienti i degradimit kur është e nevojshme;

2.38 "Kapaciteti i deklaruar" [kW], kapaciteti i ciklit të komprimimit të avullit të njësisë për ftohje (Pdc (Tj)) ose ngrohje (Pdh (Tj)), që i përket një temperature të jashtme Tj dhe temperaturës së brendshme (Tbr), si të deklaruara nga prodhuesi;

2.39 "Funksion", treguesi që njësia është e aftë për ftohjen a ajrit të brendshëm, ngrohjen e ajrit të brendshëm ose të dyja;

2.40 "Ngarkesa e projektimit", ngarkesa e deklaruar ftohëse (Pprojft) dhe/ose ngarkesa e deklaruar ngrohëse (Pprojng) [kW] në temperaturën reference të projektimitr, ku

a) për gjendjen ftohtëse, Pprojft është e barabartë me kapacitetin e deklaruar per ftohjen në Tj të barabartë me Tprojft;

b) për gjëndjen ngrohëse, Pprojng është e barabartë me ngarkesën e pjesshme në Tj të barabartë me Tprojng;

2.41 "Shkalla e deklaruar e eficiensës së energjisë" EERd(Tj)), shkalla e eficiensës së energjisë për një numër të kufizuar të binëve (j), të temperaturës së jashtme (Tj), siç deklarohet nga prodhuesi;

2.42 "Koeficienti i deklaruar i performancës" COPd(Tj)), koeficienti i performancës për një numër të kufizuar të specifikuar të bineve (j) të temperaturës së jashtme (Tj), siç deklarohet nga prodhuesi;

2.43 "Temperaturë bivalente" (Tbiv), temperatura e jashtme (Tj) [°C] e deklaruar për ngrohje nga prodhuesi, në të cilën kapaciteti i deklaruar është i barabartë me ngarkesën e pjesshme dhe poshtë të cilës kapaciteti i deklaruar duhet të jetë i plotësuar me kapacitetin e ngrohësit elektrik mbështetës, me qëllim që të plotësohet ngarkesa e pjesshme për ngrohje;

2.44 "Temperatura kufitare e operimit" (Tol), temperatura e jashtme [°C] e deklaruar për ngrohje nga prodhuesi, poshtë të cilës kondicioneri nuk është në gjëndje të japë kapacitetin e ngrohjes. Nën këtë temperaturë kapaciteti i deklaruar është i barabarte me zero;

2.45 "Gjëndje aktive", gjendja që i korrespondon orëve me ngarkesë për ftohje ose ngrohje të ndërtesës dhe ku është i aktivizuar funksioni i njësisë për ngrohje ose ftohje. Kjo gjendje mund të perfshijë ciklin takuar/stakuar të njësisë, me qëllim që të arrijë ose të ruajë temperaturën e kërkuar në ambientin e brendshëm;

2.46 "Gjendje e stakuar e termostatit", gjendja që i korrespondon orëve me ngarkesë pa ngrohje ose ftohje ndërsa funksioni i njësisë për ftohje ose ngrohje është në gjendje të takuar por njësia nuk është funksionale pasi nuk ka ngarkesë ngrohëse ose ftohëse. Si rrjedhojë, kjo gjëndje është e lidhur me temperaturat e jashtme dhe jo me ngarkesat në ambientet e brëndshme. Cikli takim/stakim në gjendje aktive nuk konsiderohet si gjendje e stakuar e termostatit;

2.47 "Gjendja e operimit të ngrohësit të kompresorit", gjëndja ku njësia ka të aktivizuar një pajisje ngrohëse për të shmangur dërgimin e lëndës ftohëse në kompresor, me qëllim që të kufizohet koncentrimi i lëndes ftohëse në vaj në momentin e dezjes së kompresorit;

2.48 "Orët e operimit me gjendje të termostatit të stakuar" (HTO), numri vjetor i orëve [orë/vit], ku njësia konsiderohet me termostat të stakuar, vlera e të cilës varet nga stina dhe funksionimi;

2.49 "Orët e operimit në gjendje të takuar" (HSB), numri vjetor i orëve [orë/vit] i njësisë, e konsideruar të jetë në gjendje gadishmërie, vlera e të cilës varet nga stina dhe funksionimi;

2.50 "Orët në gjendje të stakuar" (HOFF), numri vjetor i orëve [orë/vit] e njësisë që konsiderohet të jetë në gjendje të stakuar, vlera e të cilës varet nga stina dhe funksionimi;

2.51 "Orët e operimit në gjendjen me operim të ngrohësit të kompresorit" (HCK), numri vjetor i orëve [orë/vit] e njësisë, e konsideruar të jetë në gjëndje operimi të ngrohësit të kompresorit, vlera e të cilave varet nga stina dhe funksionimi;

2.52 "Konsumi i energjisë për kondicionerët me një dhe dy kalime" (respektivisht QSD dhe QDD), konsumi i energjisë për kondicionerët me një dhe dy kalime ajri për ftohje dhe/ose ngrohje (cilado që zbatohet), me një kalim në kWh/orë dhe me dy kalime kWh/vit;

2.53 "Shkalla e kapacitetit", raporti i kapacitetit total të deklaruar për ftohje ose për ngrohje i të gjitha njësive të brëndshme, me kapacitetin deklaruar të ftohjes ose të ngrohjes të njësisë së jashtme në kushte standarde vlerësimi.

### 3. Etiketa, dizenjinimi/formati dhe përmbajtja e saj.

Furnizuesi siguron për çdo kondicioner një etiketë të printuar, sipas kërkesave të këtij rregulli teknik, duke respektuar klasat e efiçencës së energjisë, të dhëna në pikën 7, dhe në pikat e shitjes, tregtarët sigurojnë që çdo kondicioner ka të vendosur etiketën e dhënë nga furnizuesi, në përputhje me këtë pikë, në pjesën e përparme ose në pjesën më të sipërme të saj, në mënyrë qartësisht të dukshme.

Kondicionerët, duke përjashtuar kondicionerët me një dhe dy kalime, duhet të kenë të vendosur etiketën, të paktën, në paketimin e njësisë së jashtme, për të paktën një kombinim të njësive të brendshme dhe të jashme në raport kapacitetit 1. Për kombinime të tjera, informacioni mund të ofrohet si alternativë e lirë vlerësimi në *website*.

Në paketim, dokumentacionin e produktit dhe në çdo material publicitar, qofshin këto elektronike ose në letër, për kondicionerët me një kalim ajri vendoset emërtimi "kondicionerë lokal".

Gjithashtu furnizuesi siguron për çdo kondicioner, si informacion plotësues, instruksionet e përdorimit në gjuhën shqipe.

### 3.1 Etiketa e kondicionerëve, përjashtuar kondicionerët me një dhe dy kalime ajri

3.1.1 Kondicionerë me kthim të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçensës nga A deri në G



a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. emri i furnizuesit ose marka tregtare;

II. indentifikimi i modelit të furnizuesit;

III. teksti "SEER" dhe "SCOP" për ftohjen dhe ngrohjen, përkatësisht me logon blu dhe treguesin e valës së ajrit për SEER dhe me logon e kuqe dhe treguesin e valës së ajrit për SCOP;

IV. efiçenca e energjisë; koka e shigjetes që përmban klasën e efiçencës së energjisë të pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë. Efiçenca e energjisë duhet të jepet për ftohjen dhe ngrohjen. Për ngrohjen, efiçenca e energjisë është e detyrueshme për stinën mesatare të ngrohjes. Treguesit efiçencës së energjisë për të treguar stinët më të ngrohta dhe më të ftohta nuk është e detyruar;

V. për gjendjen e ftohtë: ngarkesën e projektuar në kW, e rrumbullakosur në një shifër pas presjes dhjetore;

VI. për gjendjen e ngrohtë: ngarkesa e projektuar në Kw, për tre stinët e ngrohta e rrumbullakosur në një shifër pas presjes dhjetore;. Vlerat për stinët e ngrohta për të cilat nuk sigurohet ngarkesa e projektuar tregohen me "X";

VII. për gjendjen e ftohtë: shkalla stinore e efiçencës së energjisë (vlera e SEER), e rrumbullakosur në një shifër pas presjes dhjetore;;

VIII. për gjendjen e ngrohtë: koeficienti i performancës (vlera SCOP), për tre stinët e ngrohta, i rrumbullakosur në në një shifër pas presjes dhjetore. Vlerat për stinët e ngrohta për të cilat SCOP nuk sigurohet tregohen me "X";

IX. konsumi vjetor i energjisë në kWh për ngrohje dhe ftohje, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Vlerat për profilet klimatike për të cilat nuk është i siguruar konsumi vjetor i energjisë tregohen me "X;

X. nivelet e fuqisë së zhurmës akustike për njesitë në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm të shprehura ne dB(A) kundrejt/referuar 1 pW, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

XI. Harta evropiane që paraqet tre stinët e ngrohta dhe ngjyrat korresponduese të siperfaqeve.

Të gjitha vlerat e kërkuara duhet të përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketës të jetë në përputhje me nënpikën 3.1.5. Mund të shtohet një kopje e etiketës EU Eco kur është në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.1.2 Kondicionerët me kthim të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçencës nga A+ deri në F




a) Në etiketë përfshihet informacioni i dhënë në nënpikën 3.1.1.
b) Dizenjimi/formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.1.5.

3.1.3 Kondicionerët me kthim të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçensës nga A++ deri në E



a) Në etiketë përfshihet informacioni i dhënë në nënpikën 3.1.1.
b) Dizenjimi/formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.1.5.

3.1.4 Kondicionerët me kthim të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçensës nga A+++ deri në D.




a) Në etiketë përfshihet informacioni i dhënë në nënpikën 3.1.1.
b) Dizenjimi/formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.1.5.

3.1.5 Dizenjimi/formati i etiketës




Ku:

a) Etiketa të jetë së paku 120 mm e gjërë dhe 210 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj është në përpjestim me specifikimet e mësipërme;

b) Sfondi është i bardhe;

c) Ngjyrat janë CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shëmbull: 00-70-X-00: e kaltër 0%, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.

d) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme ( numurat i referohen figurës së mësipërme).

1 **Korniza e jashtme e etiketës:** 5pt, ngjyra e kalter 100%, rakordimet në kënde 3.5 mm.

2 **Logo EU**: Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

3 **Logo e energjisë**: Ngjyra: X-00-00-00.

Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë

Gjerësia 102 mm, lartësia 20 mm.

4 **Kufiri i nënlogove**: 1pt, ngjyra: 100% e kaltër, gjatësia 103.6 mm.

5 Treguesi SEER dhe SCOP:

Kufiri 2 pt, ngjyra: 100% e kaltër, rakordimet në kënde 3.5 mm

Teksti: kalibër i rregullt 10 pt, gërma kapitale, 100% e zezë,

6 **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm, hapësira 1 mm, ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00

Klasa e dytë: 70-00-X-00,

Klasa e tretë: 30-00-X-00.
Klasa e katërt: 00-00-X-00.
Klasa e pestë: 00-30-X-00.
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00.
Klasa e fundit: 00-X-X-00.
Teksti: Kalibër bolt 16 pt, gërma kapitale. të bardha.

7 **Klasa/at e efiçensës së energjisë**

- Shigjeta: gjerësia 11 mm. lartësia: 10 mm. 100% e zezë:
- Teksti: Kalibër bold 18 pt, gërma kapitale. të bardha.

8 **Energjia**

- Teksti: Kalibër i rregullt 9 pt. gërma kapitale, 100% e zezë.

9 **Kapaciteti nominal për ftohjen dhe ngrohjen në Kw:**

- Teksti "kW": Kalibri i rregullt 10 pt. 100% e zezë.
- Vlera "XYZ" Kalibër bolt 11 pt. 100% e bardhë.

10 **Vlerat e SCOP dhe SEER**, të rrumbullakosura deri në presjen e parë dhjetore:

- Teksti "SEER"/"SCOP": Kalibër i rregullt 10 pt, 100% e zezë.
- Vlera "X.Y": Kalibri bolt 11 pt, 100% e zezë.

11 **Konsumi vjetor i energjisë në Kwh/vit:**

- Teksti "kWh/vit": Kalibër i rregullt 10 pt. 100% e zezë.
- Vlera "XY": Kalibër bolt 11 pt. 100% e zezë.

12 **Emetimet e zhurmës**

- Korniza: 2pt – ngjyra: 100% e kaltër – rakordimet në kënde 3.5 mm.
- Vlera: Kalibër bolt 15 pt. 100% e zezë
- Kalibër i rregullt 12 pt, 100% e zezë.

13 **Harta evropiane dhe ngjyrat e sipërfaqeve**

- Ngjyrat:

Portokalli: 00-46-46-00.
Jeshile: 59-00-47-00.
Blu: 54-08-00-00.

14 **Emri ose marka tregtare e produktit**

15 **Identifikimi i modelit të furnizuesit.**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit të jenë në një hapësirë 102 x 13 mm.

16 **Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt.

3.2 Etiketa e kondicionerëve, përjashtuar kondicionerët e ajrit me një dhe dy kalime të ajrit

3.2.1 Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e energjisë nga A deri në G




a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtem:

I. emri i furnizuesit ose marka trgtare:

II. Indentifikimi i modelit të furnizuesit:

III. teksti "SEER" me logon blu dhe treguesin e valës së ajrit:

IV. efiçensa e energjisë: koka e shigjetes që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes të vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçencës së energjisë.

V. ngarkesa e projektuar për ftohjen në Kw. e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VI. shkalla e efiçencës stinore të energjisë (vlera SEER). e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VII. konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit. i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

VIII. nivelet e fuqisë së zhurmës akustike për njesitë në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm të shprehura ne dB(A) kundrejt/referuar 1 pW. rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketës të jetë në përputhje me nënpikën 3.2.5. Mund të shtohet nje kopje e etiketes EU Eco kur është në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.2.2 Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat eenergjise nga A+ deri në F.




a) Në etiketë përfshihet informacioni i nënpikës 3.2.1.
b) Dizenjimi/formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.2.5.

3.2.3 Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e energjisë nga A++ deri në E.




a) Në etikete përfshihet informacioni i nënpikës 3.2.1.
b) Dizenjimi/formati i etiketës duhet të jetë në përputhje me nënpikën 3.2.5.

3.2.4 Kondicionerët vetëm për ftohje të klasifikuar në klasat e energjisë nga A+++ deri në D.




a) Në etiketë përfshihet informacioni i nënpikës 3.2.1.

b) Dizenjimi/formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.2.5.

3.2.5 Dizenjimi/Formati i etiketës




Ku:

a) Etiketa të jetë së paku 100 mm e gjërë dhe 200 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj është në përpjestim me specifikimet e mësipërme.

b) Sfondi është i bardhë.

c) Ngjyrat janë të koduara si CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shembull 00-70-X-00: e kaltër 0%, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.
d) Etiketa ploteson të gjitha kërkesat e mëposhtme: (numrat i referohen figurës së mësipërme):

❶ **Korniza e jashtme:**

vijat: 5 pt, ngjyra e kaltër 100%, rakordimet në kënde: 3.5 mm.

❷ **Logo EU**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë**

Ngjyra: X-00-00-00.
Piktograma si e vizatuar: Logo EU + etiketa e energjisë: gjërësia 93 mm lartësia 18 mm.

❹ Kufiri i nën logove:

1 pt - ngjyra: e kaltër 100% - gjatësia 93.7 mm.

❺ **Treguesi SEER**

Teksti: Kalibër i rregullt 10 pt, gërma kapitale, të zeza 100%

❻ **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm, hapësira 1 mm, ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00
Klasa e dytë: 70-00-X-00,
Klasa e tretë: 30-00-X-00,
Klasa e katërt: 00-00-X-00.
Klasa e pestë: 00-30-X-00.
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00.
Klasa e fundit: 00-X-X-00.
Teksti: Kalibër bolt 16 pt, gërma kapitale, të bardha.

❼ **Klasa e efiçensës së energjisë**

- Shigjeta: gjërësia 23 mm, lartësia: 15 mm, 100% e zezë;
- Teksti: Kalibër bolt 18 pt, gërma kapitale, të bardha.

❽ **Energjia**

- Teksti: Kalibër i rregullt 8 pt, gërma kapitale, 100% të zeza.

❾ **Kapaciteti nominal në Kw:**

- Teksti "kW": Kalibër i rregullt 14 pt, 100% ezezë.
- Vlera "XYZ" Kalibër bolt 22 pt, 100% të zeza

❿ **Vlera e SEER, e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore :**

- Korniza 3 pt - 100% e kaltër, rakordimet në kënde 3.5 mm.
- Teksti "SEER" Kalibër i rregullt 14 pt, gërma kapitale, 100% të zeza.

⓫ **Konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit:**

- Teksti "kW orë/vit": Kalibër i rregullt 14pt, 100% e zezë.
- Vlera "XY": Kalibë bolt 22 pt, 100% e zezë.

**⓬ Emetimet e zhurmës**

- Korniza: 2pt – ngjyra: 100% e kaltër – rakordimet në kënde 3.5 mm.
- Vlera: Kalibë bolt 15 pt, 100% e zezë
- Teksti Kalibër i rregullt 12 pt, 100% e zezë.

**⓭ Emri ose marka tregtare e produktit**

**⓮ Identifikimi i modelit të furnizuesit.**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit duhet të vendoset në një hapësirë 90 x 15 mm.

**⓯ Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt.

3.3 Etiketa e kondicionerëve, përjashtuar kondicionerët me një dhe dy kalime të ajrit

3.3.1 Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e efiçensës së energjisë nga A deri në G




a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. emri i furnizuesit ose marka trgtare:

II. indentifikimi i modelit të furnizuesit:

III. teksti "SCOP" me logon blu dhe valën treguese të ajrit:

IV. efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që përmban klasën e efiçensës së energjisë së pajisjes të vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjisë. Efiçenca e energjisë për stinën me ngrohje mesatare është e detyruar. Treguesi efiçensës së energjisë për të treguar klima më të ngrohta dhe më të ftohta nuk është i detyruar;

V. ngarkesa e projektimit për ngrohje në kW për tre stinët e ngrohta e rrumbullakosur në shifrën e pare pas presjes dhjetore. Vlerat për stinët e ngrohta për të cilat nuk është siguruar ngarkesa e projektuar duhet të tregohen me "X";

VI. koefiçenti stinor i performancës (SCOP) për tre stinët e ngrohta i rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetor. Vlerat për stinët e ngrohta për të cilat SCOP nuk është siguruar të jepet si "X";

VII. konsumi vjetor i energjisë në kWh/vit i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Vlerat për stinët e ngrohta për të cilat nuk është i parashikuar konsumi vjetor i energjisë të tregohet me "X";

VIII. nivelet e fuqisë së zhurmes për njësitë/paisjet e brendshme dhe të jashtme i shprehur në dB(A) kundejt/referuar 1 pW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

IX. Harta evropiane që shpreh tre stinët e ngrohta dhe ngjyrat koresponduese të sipërfaqeve.

Të gjitha vlerat e kerkuara përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Etiketa të jetë në përputhje me nënpikën 3.3.5. Mund të shtohet një kopje e etiketës EU Eco kur është në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.3.2 Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e energjise nga A+ deri në F




a) Në etiketë përfshihet informacioni i dhënë në nënpikën 3.3.1.

b) Dizenjimi/formati i etiketës të jetë në përputhje me nënpikën 3.3.5

3.3.3 Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e energjisë nga A$^{++}$ deri në E.




a) Etiketa përfshin informacionin e dhënë në nënpikën 3.3.1.
b) Dizenjimi/formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.3.5

3.3.4 Kondicionerët vetëm për ngrohje të klasifikuar në klasat e energjisë nga A+++ deri në D.




a) Në etiketë përfshihet informacioni i dhënë në nënpikën 3.3.1.
b) Formati i etiketës është në përputhje me nënpikën 3.3.5.

### 3.3.5 Dizenjimi/Formati i etiketës




Ku

a) Etiketa të jete së paku 100 mm e gjërë dhe 200 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj është në përpjestim me specifikimet e mësipërme.

b) Sfondi është i bardhë.

c) Ngjyrat janë CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shembull: 00-70-X-00: e kaltër 0%, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.

d) Etiketa ploteson të gjitha kërkesat e mëposhtme ( numrat i referohen figurës së mësiperme).

❶ **Korniza e jashtme e etiketës:**

Vijat 5pt, ngjyra e kaltër 100%, rakordimet në kënde 3.5 mm.

❷ **Logo EU:**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ Etiketa e energjisë:

Ngjyra: X-00-00-00.

Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë: gjërësia 102 mm, lartësia 20 mm.

❹ **Kufiri i nënlogove:**

1pt, ngjyra: 100% e kaltër, gjatësia 93.7 mm.

❺ **Treguesi SCOP:**

Teksti: kalibër i rregullt 10 pt, gërmat kapitale, 100% e zezë.

❻ **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm, hapësira 1 mm, ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00
Klasa e dytë: 70-00-X-00,
Klasa e tretë: 30-00-X-00,
Klasa e katërt: 00-00-X-00.
Klasa e pestë: 00-30-X-00,
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00.
Klasa e fundit: 00-X-X-00.
Teksti: Kalibër bolt 18 pt. gërma kapitale, të bardha.

**7. Klasa/t e efiçenses së energjisë**

- Shigjeta: gjerësia 11 mm, lartësia: 10 mm, 100% të zeza:
- Teksti: Kalibër bolt 18 pt, germa kapitale, të bardha.

**8. Kapaciteti nominal në kW**

- Teksti: "kW"Kalibër i rregullt 10 pt., 100% e zezë.
- Vlera "XY.Z": Kalibër bolt 11. 100% e zezë

**9. Vlerat e SCOP** të rrumbullakosura në shifrën e pare pas presjes dhjetor:

- Teksti "SCOP": Kalibër i rregullt 10 pt, 100% e zezë.
- Vlera "X.Y": Kalibër bolt 11 pt, 100% e zezë.

10. Konsumi vjetor i energjisë në Kwh/vit

- Teksti "kWh/vit": Kalibër i rregullt 11 pt, 100% e zezë.
- Vlera "XY": Kalibër bolt 11 pt. 100% e zezë.

**11. Emetimet e zhurmës**

- Korniza: 2pt – ngjyra: 100% e kaltër – rakordimet në kënde 3.5 mm.
- Vlera: Kalibë bolt 15 pt. 100% e zezë
- Teksti 12 pt. 100% e zezë.

**12. Harta evropiane dhe ngjyrat e sipërfaqeve**

- Ngjyrat:

Portokalli: 00-46-46-00.
Jeshile: 59-00-47-00.
Blu: 54-08-00-00.

**13. Emri ose marka tregtare e furnizuesit**

**14. Identifikimi i modelit të furnizuesit.**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit duhet të vendoset në një hapësirë 90 x 15 mm.

**15. Energjia**

- Teksti: Kaliber i rregullt 8 pt. 100% e zezë.

**16. Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibri bolt 10 pt.

3.4 Etiketa e kondicionerëve me dy kalime të ajrit

3.4.1 Kondicionerët me kthim të ajrit me dy kalime të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë nga A+++ deri në D




a) Në etiketë përfshihet informacioni i mëposhtëm:

I. emri ose marka tregtare e furnizuesit:

II. identifikimi i emrit të furnizuesit:

III. teksti "EER" dhe "COP" për ftohjen dhe ngrohjen. përkatësisht me një logo blu dhe me treguesin e valës së ajrit për EER dhe logon e kuqe me valën treguese të ajrit për COP:

IV. efiçenca e energjisë; koka e shigjetes që përmban klasën e efiçencës së energjisë së pajisjes të vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjisë. Efiçenca e energjisë tregohet për ftohjen dhe ngrohjen:

V. ngarkesa e projektimit për ftohje e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VI. EERnom dhe COPnom. rrumbullakosur deri në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VII. Konsumi në 1 orë i energjisë kWh për 60 minuta. për gjëndjen e ftohjes dhe të ngrohjes. rrumbullakuar në numrin e plotë më të afërt:

VIII. nivelet e fuqisë së zhurmes për njësinë/paisjen e brëndshme të shprehur në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW. i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

Të gjitha vlerat e kërkuara përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Etiketa është në përputhje me nënpikën 3.4.2. Mund të shtohet një kopje e etiketës EU Eco kur është në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.4.2 Dizenjimi/Formati i etiketës



Ku:

a) Etiketa të jetë së paku 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e tij duhet të jetë në përpjestim me specifikimet e mësipërme.

b) Sfondi është i bardhë.

c) Ngjyrat janë CMYK – e kaltër . e kuqe e purpurt. e verdhë dhe e zezë. si shembull: 00-70-X-00: e kaltër 0%. e kuqe e purpurt 70%. e verdhë 100%. e zezë 0%.

d) Etiketa duhet të plotesojë kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figures së mësipërme):

❶ **Korniza e jashtme e etiketës:**

Vijat 5pt, ngjyra e kaltër 100%, rakordimet në kënde 3.5 mm.

❷ **Logo EU:**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:**

Ngjyra: X-00-00-00.

Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë: gjerësia 82 mm, lartësia 16 mm.

❹ **Kufiri i nënlogove:**

1pt, ngjyra: 100% e kaltër, gjatësia 92.5 mm.

❺ **Treguesi EER dhe SCOP:**

Teksti: kaliber i rregullt 10 pt, kapitale, 100% e zeze.

❻ **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartesia 7 mm, hapësira 1.3 mm, ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00
Klasa e dytë: 70-00-X-00,
Klasa e tretë: 30-00-X-00,
Klasa e katërt: 00-00-X-00,
Klasa e pestë: 00-30-X-00,
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,
Klasa e fundit: 00-X-X-00.
Teksti: Kalibri bolt 18 pt. germa kapitale, te bardha.
Kalibri bolt 7 pt. e bardhe.

7 **Klasat e efiçensës së energjisë**

- Shigjeta: gjërësia 11 mm. lartësia: 10 mm. 100% e zezë:
- Teksti: Kalibër bolt 18 pt. gërma kapitale. të bardha.

Kalibër bolt 7 pt. e bardhë .

8 **Energjia:**

- Teksti: Kliber i rregullt 8 pt. e zezë 100%.

9 "Dokumenti" - përkthimi

Teksti: Kalibër i rregullt 7 pt. e zezë 100 %.

10 Kapaciteti nominal për gjëndjen e ftohjes dhe të ngrohjes në KW:

- Teksti "kW": Kalibër i rregullt 14 pt: e zeze 100%.
- Vlera "XY.Z": Kalibër bolt 22 pt. e zeze 100%

11 Vlerat COP dhe EER, të rrumbullakosura në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

- Teksti "EER"/"COP": Kalibër i rregullt 14 pt. gërma kapitale. e zezë 100%
- Vlera "XY": Kalibë bolt 22 pt. e zezë 100%

12 Konsumi në 1 orë i energjisë në Kwh/60 min:

- Teksti "kWorë/60min*": Kalibë i rregullt 14 pt. e zezë 100 %
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22. e zezë 100 %

13 Emetimi i zhurmës:

- Korniza: 2 pt – ngjyra e kaltër 100%. rakordimet në kënde: 3.5 mm.
- Vlera: Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%.
- Teksti: Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100%.

Emri ose marka tregtare e furnizuesit

14 Emri ose marka tregtare e furnizuesit.

15 Identifikimi i modelit të furnizuesit.

Emri i furnizuesit marka tregtare dhe identifikimi i modelit vendosen në hapësirën 82 x 10.5 mm.

16 Periudha e referimit

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt.

3.4.3 Kondicionerët vetëm për ftohje me dy kalime të ajrit të klasifikuara në klasat e efiçencës nga $A^{+++}$ deri D




a) Etiketa përfshin informacionin e mëposhtëm:

I. emrin e furnizuesit ose markën tregtare;

II. identifikimin e modelit të furnizuesit:

III. teksti "EER" me logon blu dhe me treguesin e valës së ajrit;

IV. efiçenca e energjisë: koka e shigjetës qe përmban klasen e efiçensës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjisë:

V. kapaciteti nominal për ftohjen në kW, e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore;

VI. EEE nominale, e rrumullakosur deri në shifrën e parë pas presjes dhjetore;

VII. konsumi në orë i energjisë në Kwh për 60 minuta, i rrumbullakosur në numrin e plotë me të afërt:

VII. niveli i fuqisë së zhurmes për ambientin e brendshëm i shprehur në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW, i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afert:

Të gjitha vlerat e kërkuara duhet të përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketës të jetë në përputhje me nënpikën 3.4.4. Mund të shtohet nje kopje e etiketes EU Eco kur është në përputhje me legjislacionin përkatës.

### 3.4.4 Dizenjimi/Formati i etiketës




Ku

a) Etiketa të jetë së paku 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh. përmbajtja e saj duhet të jetë në përpjestim me specifikimet e mësipërme.

b) Sfondi duhet të jetë i bardhë.

c) Ngjyrat duhet te jene si CMYK – e kaltër. e kuqe e purpurt. e verdhë dhe e zezë. si shëmbull: 00-70-X-00: e kaltër 0%. e kuqe e purpurt 70%. e verdhë 100%. e zezë 0%.

d) Etiketa ploteson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësiperme):

❶ **Korniza e jashtme e etiketës:**

Vijat 5pt. ngjyra e kaltër 100%. rakordimet në kënde 3.5 mm.

❷ **Logo EU:**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

❸ **Etiketa e energjisë:**

Ngjyra: X-00-00-00.

Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë: gjerëia 82 mm. lartësia 16 mm.

❹ **Kufiri i nënlogove:**

1pt. ngjyra: 100% e kaltër. gjatësia 92.5 mm.

❺ **Treguesi EER**

Teksti: kalibër i rregullt 10 pt. gërma kapitale. 100% e zezë.

❻ **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm, hapësira 1.3 mm. ngjyrat:
Klasa më e lartë: X-00-X-00
Klasa e dytë: 70-00-X-00.
Klasa e tretë: 30-00-X-00,
Klasa e katërt: 00-00-X-00.
Klasa e pestë: 00-30-X-00.
Klasa e gjashtë: 00-70-X-00.
Klasa e fundit: 00-X-X-00.
Teksti: Kalibër bolt 18 pt, gërma kapitale, të bardha.
Kalibri bolt 7 pt. e bardhë.

❼ **Klasa e efiçensës së energjisë**

- Shigjeta: gjerësia 20 mm. lartësia: 15 mm, 100% e zezë:
- Teksti: Kalibri bolt 30 pt, gërma kapitale, të bardha.
Kalibër bolt 14 pt. e bardhë.

❽ **Energjia:**

- Teksti: Klibër i rregullt 8 pt. e zezë 100%.

❾ **"Dokumenti"** - përkthimi

Teksti: Kalibër i rregullt 7 pt, e zezë 100 %.

❿ **Kapaciteti nominal në KW:**

- Teksti "kW": Kalibër i rregullt 14 pt: e zezë 100%.
- Vlera "XY.Z": Kalibër bolt 22 pt, e zezë 100%

⓫ **Vlera EER**, e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

- Teksti "EER": Kalibër i rregullt 14 pt. gërma kapitale, e zezë 100%
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%

⓬ **Konsumi në 1 orë i energjisë në Kwh/60min:**

- Teksti "kWh/60min*": Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100 %
- Vlera "XY": Kalibri bolt 22. e zeze 100 %

⓭ **Emetimi i zhurmës:**

- Korniza: 2 pt – ngjyra e kaltër 100%, rakordimet në kënde: 3.5 mm.
- Vlera: Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%.
- Teksti: Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100%.

⓮ **Emri ose marka tregtare e furnizuesit.**

⓯ Identifikimi i modelit të furnizuesit.

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit duhet të përshtatet në një siperfaqe 82x10.5 mm

⓰ Periudha e referimit

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt.

3.4.5 Kondicionerët vetëm për ngrohje me dy kalime të ajrit të klasifikuar në klasat e energjisë nga A$^{+++}$ deri në D




a) Etiketa përfshin informacionin e mëposhtem:

I. emrin e furnizuesit ose markën tregtare:

II. identifikimin e modelit nga furnizuesi:

III. tekstin "COP" me logon e kuqe dhe me treguesin e valës së ajrit:

IV. efiçenca e energjisë: koka e shigjetës që permban klasën e efiçensës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjisë:

V. kapaciteti nominal për ngrohjen në kW. e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VI. COP nominale i rrumbullakosur deri në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VII. konsumi në 1 orë i energjisë në Kwh për 60 minuta. e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afert:

VIII. niveli i fuqisë së zhurmës për ambientin e brendshëm në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW. e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

Të gjitha vlerat e kërkuara duhet të përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketes është në përputhje me nënpikën 3.4.6. Mund të shtohet një kopje e etiketës e EU Eco. kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës.

### 3.4.6 Dizenjimi/Formati i etiketës



Ku:

a) Etiketa të jetë së paku 10 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë . Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj eshtë në përpjestim me specifikimet e mesiperme.

b) Sfondi eshtë i bardhë.

c) Ngjyrat duhet të jenë CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shembull: 00-70-X-00: e kaltër 0%, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.

d) Etiketa duhet të plotesojë të gjitha kërkesat e mëposhtme: (numrat i referohen figurës së mësipërme):

1 **Korniza e jashtme e etiketës:**

Vijat 5pt, ngjyra e kaltër 100%, rakordimet në kënde 3.5 mm.

2 **Logo EU:**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

3 **Etiketa e energjisë:**

Ngjyra: X-00-00-00.

Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë: gjerësia 82 mm, lartësia 16 mm.

4 **Kufiri i nënlogove:**

1pt, ngjyra: 100% e kaltër, gjatësia 92.5 mm.

5 **Treguesi COP**

Teksti: kalibër i rregullt 10 pt. gërma kapitale. 100% e zezë.

**6 Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm. hapësira 1.3 mm. ngjyrat:

Klasa më e lart: X-00-X-00

Klasa e dytë: 70-00-X-00.

Klasa e tretë: 30-00-X-00.

Klasa e katërt: 00-00-X-00.

Klasa e pestë: 00-30-X-00.

Klasa e gjashtë: 00-70-X-00.

Klasa e fundit: 00-X-X-00.

Teksti: Kalibër bolt 18 pt. gërma kapitale. të bardha.

Kalibër bolt 7 pt, e bardhë.

**7 Klasa e efiçensës së energjisë:**

- Shigjeta: gjerësia 20 mm. lartësia: 15 mm. 100% e zezë:
- Teksti: Kalibër bolt 30 pt. gërma kapitale. të bardha.

Kalibri bolt 14 pt. e bardhe.

**8 Energjia:**

- Teksti: Kalibër i rregullt 8 pt. e zezë 100%.

9 "Dokumenti" Përkthim

Teksti: Kaliber i rregullt 7 pt. e zeze 100 %.

10 Kapaciteti nominal në Kw:

- Teksti "kW": Kalibër i rregullt 14 pt: e zezë 100%.
- Vlera "XY.Z": Kalibër bolt 22 pt, e zezë 100%

11 **Vlera COP.** e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

- Teksti "COP": Kalibër i rregullt 14 pt. gërma kapitale. e zezë 100%
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%

**12 Konsumi në 1 orë i energjise në Kwh/60 min:**

- Teksti "kWorë/60min*": Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100 %
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22. e zezë 100 %

**13 Emetimi i zhurmës:**

- Korniza: 2 pt – ngjyra e kalter 100%. rakordimet ne kende: 3.5 mm.
- Vlera: Kalibri bolt 22 pt. e zezë 100%.
- Teksti: Kaliber i rregullt 14 pt. e zezë 100%.

**14 Emri ose marka tregtare e furnizuesit.**

**15 Identifikimi i modelit të furnizuesit.**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit duhet të përshtatet në një sipërfaqe 82x10.5 mm

(16) **Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt

3.5 Etiketa e kondicionerëve me një kalim të ajrit

3.5.1 Kondicionerët me kthim të ajrit me një kalim të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçencës së energjisë nga A+++ deri në D.




a) Etiketa të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

I. emrin e furnizuesit ose markën tregtare:

II. identifikimin e modelit nga furnizuesi:

III. tekstin "EER" dhe "COP" për ftohje dhe ngrohje, përkatësisht me logon blu dhe me treguesin e valës të ajrit për EER dhe logon e kuqe me treguesin e valës së ajrit për COP:

IV. efiçenca e energjisë: koka e shigjetës që përmban klasën e efiçensës së energjisë së pajisjes të vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjise. Efiçenca e energjisë duhet të tregohet për ftohjen dhe ngrohjen:

V. kapaciteti nominal për ftohjen dhe ngrohjen në kW, e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VI. EERnom dhe COPnom të rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VII. konsumi në 1 orë i energjisë në Kwh për 60 minuta, i rrumbullakosur në numrin e plotë me të afërt:

VIII. niveli i fuqisë së zhurmës për ambientin e brendshëm në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

Të gjitha vlerat e kërkuara duhet të përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketës duhet të jetë në përputhje me nënpikën 3.5.2 Mund të shtohet një kopje e etiketës e EU Eco, kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.5.2 Formati i etiketës




Ku:

a) Etiketa të jetë së paku 100 mm e gjërë dhe 200 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh, përmbajtja e saj duhet të jetë në përpjestim me specifikimet e mësipërme.
b) Sfondi duhet të jetë i bardhë.
c) Ngjyrat duhet të jenë si CMYK – e kaltër, e kuqe e purpurt, e verdhë dhe e zezë, si shëmbull: 00-70-X-00: e kaltër 0%, e kuqe e purpurt 70%, e verdhë 100%, e zezë 0%.
d) Etiketa duhet të plotesojë të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësipërme):

**1** **Korniza e jashtme e etiketës:**

Vijat 5pt, ngjyra e kaltër 100%, rakordimet në kënde 3.5 mm.

**2** **Logo EU:**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

**3** **Etiketa e energjisë:**

Ngjyra: X-00-00-00.

Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë: gjerësia 82 mm, lartësia 16 mm.

**4** Kufiri i nënlogove:

1pt. ngjyra: 100% e kaltër. gjatësia 92.5 mm.

5 **Treguesi EER dhe COP**

- korniza 2 pt – ngjyra: e kaltër 100%. rakordimet në kënde 3.5 mm

Teksti: kalibër i rregullt 10 pt. gërma kapitale. 100% e zezë.

6 **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm. hapësira 1.3 mm. ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00

Klasa e dytë: 70-00-X-00.

Klasa e tretë: 30-00-X-00.

Klasa e katërt: 00-00-X-00.

Klasa e pestë: 00-30-X-00.

Klasa e gjashtë: 00-70-X-00,

Klasa e fundit: 00-X-X-00.

Teksti: Kalibër bolt 18 pt. gërma kapitale. të bardha.

Kalibri bolt 7 pt, e bardhë.

7 Klasat e efiçensës së energjisë

- Shigjeta: gjërësia 11 mm. lartësia: 10 mm. 100% e zezë:
- Teksti: Kalibër bolt 18 pt. gërma kapitale, të bardha.

8 **Energjia:**

- Teksti: Kalibër i rregullt 8 pt. e zezë 100%.

9 "Dokumenti" përkthim

Teksti: Kalibër i rregullt 7 pt. e zezë 100 %.

10 **Kapaciteti nominal për ftohje dhe ngrohje në Kw:**

- Teksti "kW": Kalibër i rregullt 14 pt: e zezë 100%.
- Vlera "XY.Z": Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%

11 **Vlera EER dhe COP**. të rrumbullakosura në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

- Teksti: Kalibër i rregullt 14 pt. gërma kapitale. e zezë 100%
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%

12 Konsumi në orë i energjisë në Kwh/60 min:

- Teksti "kWh/60min": Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100 %
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22. e zezë 100 %

13 **Emetimi i zhurmës:**

- Korniza: 2 pt – ngjyra e kaltër 100%. rakordimet në kënde: 3.5 mm.
- Vlera: Kalibri bolt 22 pt. e zezë 100%.
- Teksti: Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100%.

14 **Emri ose marka tregtare e furnizuesit.**

15 **Identifikimi i modelit të furnizuesit.**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit duhet të përshtatet në një sipërfaqe 82x10.5 mm

**16 Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibër bolt 10 p

3.5.3 Kondicionerët vetëm për ftohje me një kalim të ajrit të klasifikuar në klasat e energjisë nga A+++ deri në D.




a) Etiketa perfshin informacionin e mëposhtëm:

I. emrin e furnizuesit ose markën tregtare;
II. identifikimin e modelit të furnizuesit;
III. tekstin "EER", me logon blu dhe me treguesin e valës së ajrit;
IV. efiçensën e energjisë: koka e shigjetës që përmban klasën e efiçensës së energjisë së pajisjes vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjisë;
V. kapacitetin nominal për ftohjen në kW, e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore;
VI. EERnom e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore;
VII. konsumin në orë të energjisë në Kwh për 60 minuta, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;
VIII. niveli i fuqisë së zhurmës për ambientin e brendshëm në dB(A) kundrejt/referuar 1 në pW, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt;

Të gjitha vlerat e kërkuara duhet të përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketes është në përputhje me nënpikën 3.5.4. Mund të shtohet një kopje e etiketës e EU Eco. kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.5.4 Dizenjimi/Formati i etiketës




Ku:

a) Etiketa të jete së paku 100 mm e gjerë dhe 200 mm e lartë. Kur etiketa printohet në një format më të madh. përmbajta e saj duhet të jetë në përpjestim me specifikimet e mësipërme.
b) Sfondi është i bardhë.
c) Ngjyrat janë CMYK – e kaltër. e kuqe e purpurt. e verdhë dhe e zezë. si shëmbull: 00-70-X-00: e kaltër 0%. e kuqe e purpurt 70%. verdhë 100%. e zezë 0%.
d) Etiketa plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme (numrat i referohen figurës së mësiperme):

**1 Korniza e jashtme e etiketës:**

Vijat 5pt. ngjyra e kaltër 100%. rakordimet në kënde 3.5 mm.

**2 Logo EU:**

Ngjyrat: X-80-00-00 dhe 00-00-X-00.

**3 Etiketa e energjisë:**

Ngjyra: X-00-00-00.
Piktograma si e vizatuar: logo EU + etiketa e energjisë: gjerësia 82 mm. lartësia 16 mm.

**4 Kufiri i nënlogove:**

1pt. ngjyra: 100% e kaltër. gjatësia 92.5 mm.

**5 Treguesi EER**

-Teksti: kalibër i rregullt 10 pt. gërma kapitale. 100% e zezë.

❻ **Shkalla A – G**

- Shigjeta: lartësia 7 mm. hapësira 1.3 mm, ngjyrat:

Klasa më e lartë: X-00-X-00

Klasa e dytë: 70-00-X-00,

Klasa e tretë: 30-00-X-00.

Klasa e katërt: 00-00-X-00,

Klasa e pestë: 00-30-X-00.

Klasa e gjashtë: 00-70-X-00.

Klasa e fundit: 00-X-X-00.

Teksti: Kalibër bolt 18 pt, gërma kapitale. të bardha.

Kalibri bolt 7 pt. e bardhë.

❼ **Klasat e efiçencsës së energjisë**

- Shigjeta: gjërësia 20 mm. lartësia: 15 mm. 100% e zezë:
- Teksti: Kalibër bolt 30 pt, gërma kapitale. të bardha.

❽ **Energjia**:

- Teksti: Kalibër i rregullt 8 pt. e zezë 100%.

❾ **"Dokumenti"** përkthimi:

Teksti: Kalibër i rregullt 7 pt. e zez ë 100 %.

❿ **Kapaciteti nominal në Kw**:

- Teksti "kW": Kalibër i rregullt 14 pt: e zezë 100%.
- Vlera "XY.Z": Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%

⓫ **Vlera EER**, e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

- Teksti "EER": Kalibër i rregullt 14 pt. gërma kapitale. e zezë 100%
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%

⓬ **Konsumi në orë i energjisë** ne Kwh/60 min:

- Teksti "kWorë/60min": Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100 %
- Vlera "XY": Kalibër bolt 22. e zezë 100 %

⓭ **Emetimi i zhurmës:**

- Korniza: 2 pt – ngjyra e kaltër 100%. rakordimet në kënde: 3.5 mm.
- Vlera: Kalibër bolt 22 pt. e zezë 100%.
- Teksti: Kalibër i rregullt 14 pt. e zezë 100%.

⓮ **Emri ose marka tregtare e furnizuesit.**

⓯ **Identifikimi i modelit të furnizuesit.**

Emri i furnizuesit ose marka tregtare dhe identifikimi i modelit duhet të përshtatet në një sipërfaqe 82x10.5 mm

⓰ **Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt.

3.5.5 Kondicionerët vetëm për ngrohje me një kalim të ajrit të klasifikuar në klasat e efiçeencës së energjisë A+++ deri në D




a) Etiketa të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

I. mrin e furnizuesit ose markën tregtare:

II. identifikimin e modelit të furnizuesit:

III. teksti i "COP". me logon e kuqe dhe me treguesin e valës së ajrit:

IV. efiçenca e energjisë; koka e shigjetës që prmban klasën e efiçensës së energjisë së pajisjes duhet të vendoset në të njëjtën lartësi me kokën e shigjetës së klasës përkatëse të efiçensës së energjisë:

V. kapacitetin nominal për ngrohjen në kW. i rrumbullakosur në shifrën e pare pas presjes dhjetore:

VI. COPnom e rrumbullakosur në shifrën e parë pas presjes dhjetore:

VII. konsumi në orë i energjisë në Kwh për 60 minuta. e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

VIII. niveli i fuqisë së zhurmës për ambientin e brendshëm në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW. i rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

Të gjitha vlerat e kërkuara duhet të përcaktohen në përputhje me pikën 8.

b) Dizenjimi/formati i etiketës të jetë në përputhje me nënpiken 9.5.6. Mund të shtohet një kopje e etiketës e EU Eco. kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës.

minimalisht për një kombinim të njësive të brendshme dhe të jashtme në raport kapaciteti 1. Për kombinime të tjera, informacioni mund të ofrohet si alternativë e lirë vlerësimi në *website*.

4.1 Informacioni i dhënë në skedën informative të produktit jepet sipas renditjes së mëposhtme:
   a) emri i furnizuesit ose marka tregtare:
   b) identifikimi i modelit të kondicionerit të ajrit në ambientin e brendshëm ose të elementeve të kondicionerit në ambientin e brendshëm dhe të jashtem:
   c) pa anashkaluar kërkesat lidhur me skemën e etiketës EU Eco, kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës dhe i është dhënë kjo etiketë, mund të shtohet një kopje e etiketës EU Eco,
   ç) nivelet e fuqise se zhurmës në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm në kushte standarde të vlerësimit, për gjendjen e ftohjes dhe/ose ngrohjes:
   d) emrin dhe GWP e ftohësit të përdorur dhe një tekst standard si më poshtë:
   "Rrjedhja e ftohësit kontribuon në ndryshimin klimatik. Ftohësi me potencial të ulët të ngrohjes globale (GWP) kontribon më pak në ngrohjen globale sesa një ftohës me GWP më të lartë nëse shkarkon në atmosferë Kjo pajisje përmban fluidin ftohës të barabartë me [xxx]. Kjo nënkupton që nëse 1 kg i këtij lëngu ftohës rrjedh në atmosferë. inpakti i ngrohjes globale eshte [xxx] herë më i lartë se 1 kg CO2 për një periudhë 100 vjet. Mos u përpiqni të ndërhyni në qarkun ftohës ose të çmontoni dhe gjithmonë kërkoni një profesionist".

4.2 Gjithashtu, duhet përfshirë informacioni i mëposhtem në skedën informative të kondicionerëve te ajrit për gjendjen e ftohjes. kur efiçenca deklarohet mbi bazen e shkallës stinore të të efiçencës së energjisë (SEER) :
   a) SEER dhe klasën e efiçencës së energjisë të modelit (modeli i një njësie ose kombinim i njësive) të përcaktuara në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave në pikat 2 dhe 8 per gjendjen e ftohjes së bashku me kufijtë e klasës të përcaktuar në pikën 7:
   b) konsumin vjetor të energjisë elektrike QCE në kWh/vit gjatë stinës së ftohjes, i percaktuar në përputhje me perkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht në pikat 2 dhe 8. Ai duhet përshkruar si: "Konsumi i energjise "XYZ" Kwh për vit. i bazuar në rezultatet e provave standarde. Konsumi aktual i energjisë varet se si pajisja përdoret dhe ku është e vendosur":
   c) ngarkesa e projektimit Pproj në KW e pajisjes në gjendjen ftohëse e përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht të dhëna në pikat 2 dhe 8:

4.3 Gjithashtu. përfshihen shënimet e mëposhtme që përcaktojnë informacionin në skedën informative për gjëndjen e ngrohjes kur efiçenca është e deklaruar mbi bazën e koefiçentin stinor të performancës (SCOP):
   a) SCOP dhe klasa e efiçencës së energjisë e modelit. ose kombinimi. në gjëndjen e ngrohjes të përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht të dhëna në pikat 2 dhe 8 se bashku me kufijtë e klasës si e përcaktuar në pikën 7:

b) konsumi vjetor i energjisë elektrike për stinën mesatare të ngrohjes QHE në kWh/vit, e përcaktuar në perputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht të dhëna në pikat 2 dhe 8. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "XYZ" kWh/në vit, i bazuar në rezultatet e testeve standarde. Konsumi aktual i energjisë varet se si pajisja përdoret dhe ku është e lokalizuar";

c) stinet e tjera të ngrohjes për të cilat njësia është e deklaruar si e përshtatshme për qëllimin e përdorimit. me opsionet e stinëve më të ngrohta ose më të ftohta, si të përcaktuara në pikën 2.

ç) ngarkesa e projektuar Pproj. e pajisjes në gjëndjen e ngrohjes e përcaktuar në perputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave sipas pikave 2 dhe 8.

d) kapaciteti i deklaruar dhe treguesi i rezervës për kapacitetin e ngrohjes së supozuar për llogaritjen e SCOP në referencë të kushteve të projektimit.

4.4 Gjithashtu, shkronjat a), b), c), dhe ç) të kësaj nënpike përcaktojnë informacionin që duhet të përfshihet në skedën informative të kondicionerëve, kur efiçenca është e deklaruar mbi bazën e shkallës së efiçencës së energjisë (EERnom) ose të koeficentit të performancës (COPnom):

a) klasa e efiçencës së energjisë së modelit, e përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe procedurat e proves, të pëcaktuara në pikat 2 dhe 8, së bashku me kufijtë e klasës të përcaktuar në pikën 7.

b) për kondicionerët me dy kalime të ajrit, konsumi në orë i energjisë QDP në kWh/60 minuta i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "X.Y" kWh/ për 60 minuta, i bazuar në rezultatet e provave standarde. Konsumi aktual i energjise varet se si pajisja përdoret dhe ku është e lokalizuar":

c) për kondicioneret me një kalim të ajrit, konsumi në orë i energjisë elektrike QSD në kWh/60 minuta i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "X.Y" kWh/ 60 minuta, i bazuar në rezultatet e provave standarde. Konsumi aktual i energjisë varet se si pajisja përdoret dhe ku është e lokalizuar":

ç) kapaciteti ftohës Pnom në kW i pajisjes i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8.

d) kapaciteti ngrohës Pnom në kW i pajisjes i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8.

4.5 Skeda informative mund të përmbajë numrin e modeleve të pajisjes të furnizuar nga i njëjti furnizues.

4.6 Informacioni i përfshirë në skedën informative mund të jepet në formën e një kopje etikete, me ngjyra ose bardhë e zi. Në këtë rast, duhet të sigurohet informacioni i listuar në nëpikat nga 4.

16 **Periudha e referimit**

- Teksti: Kalibër bolt 10 pt.

3.6 Formati i etiketës për kondicionerët, me përjashtim të kondicionerëve me një dhe dy kalime të ajrit, duhet të jetë në përputhje me afatet kohore të mëposhtme:

a) për kondicionerët, përjashtuar ato me një dhe dy kalime të ajrit, që vendosen në treg nga 1 qershori 2016, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A, B, C, D, E, F, G të jetë në përputhje me nënpikën 3.1.1 për kondicionerët e kthyeshem të ajrit, me nënpikën 3.2.1 për kondicionerët vetëm për ftohje dhe me nënpikën 3.3.1 për kondicioneret vetëm për ngrohje;

b) për kondicionerët, përjashtuar ato me një dhe dy kalime të ajrit, të vendosur në treg pas datës 1 janar 2017, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A+, A, B, C, D, E, F të jetë në përputhje me nënpikën 3.1.2 për kondicioneret me kthim të ajrit, me nënpikën 3.2.2 për kondicioneret vetëm për ftohje dhe me nënpikën 3.3.2 për kondicionerët vetëm për ngrohje;

c) për kondicionerët, përjashtuar kondicionerët me një dhe dy kalime të ajrit, të vendosur në treg pas datës 1 janar 2018, etiketat me klasat e efiçencës së energjise A++, A+, A, B, C, D, E të jetë në përputhje nënpikën 3.1.3 për kondicioneret me kthim të ajrit, me nënpikën 3.2.3 për kondicionerët vetëm për ftohje dhe me nënpikën 3.3.3 për kondicionerët vetëm për ngrohje;

ç) për kondicionerët, përjashtuar ato me një dhe dy kalime të ajrit, të vendosur në treg pas datës 1 janar 2020, etiketat me klasat e efiçencës së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C, D të jenë në përputhje me nënpikën 3.1.4 për kondicionerët me kthim të ajrit, me nënpikën 3.2.4 për kondicionerët veteëm për ftohje dhe me nënpikën 3.3.4 për kondicionerët vetëm për ngrohje;

3.7 Formati i etiketës për kondicionerët me dy kalime të ajrit, që vendosen në treg nga 1 qershori 2016, me klasat e efiçencës së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C, D të jenë në përputhje me nënpiken 3.4.1 për kondicionerët me kthim të ajrit me dy kalime të ajrit, me nënpikën 3.4.3 për kondicionerët me dy kalime të ajrit vetëm për ftohje dhe me nënpikën 3.4.5 për kondicionerët me dy kalime të ajrit vetëm për ngrohje.

3.8 Formati i etiketës për kondicionerët me një kalim të ajrit, që vendosen në treg nga 1 qershori 2016 me klasat e efiçences së energjisë A+++, A++, A+, A, B, C, D të jenë në përputhje me nënpikën 3.5.1 për kondicionerët me kthim të ajrit me një kalim të ajrit, me nënpikën 3.5.3 për kondicionerët me kthim të ajrit me një kalim të ajrit dhe vetëm për ftohje, dhe me nënpikën 3.5.5 per kondicionerët me një kalim të ajrit dhe vetëm për ngrohje.

**4. Skeda informative e produktit**

Për kondicionerët, përjashtuar kondicionerët me një dhe dy kalime të ajrit, skeda informative e produktit duhet të sigurohet në gjuhën shqipe, të paktën në paketimin e njësisë së jashtme.

minimalisht për një kombinim të njësive të brendshme dhe të jashtme në raport kapaciteti 1. Për kombinime të tjera, informacioni mund të ofrohet si alternativë e lirë vlerësimi në *website*.

4.1 Informacioni i dhënë në skedën informative të produktit jepet sipas renditjes së mëposhtme:

a) emri i furnizuesit ose marka tregtare;

b) identifikimi i modelit të kondicionerit të ajrit në ambientin e brendshëm ose të elementeve të kondicionerit në ambientin e brendshëm dhe të jashtem:

c) pa anashkaluar kërkesat lidhur me skemën e etiketës EU Eco. kur modeli është në përputhje me legjislacionin përkatës dhe i është dhënë kjo etiketë, mund të shtohet një kopje e etiketës EU Eco,

ç) nivelet e fuqise se zhurmës në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm në kushte standarde të vlerësimit. për gjendjen e ftohjes dhe/ose ngrohjes;

d) emrin dhe GWP e ftohësit të përdorur dhe një tekst standard si më poshtë:

"Rrjedhja e ftohësit kontribuon në ndryshimin klimatik. Ftohësi me potencial të ulët të ngrohjes globale (GWP) kontribon më pak në ngrohjen globale sesa një ftohës me GWP më të lartë nëse shkarkon në atmosferë Kjo pajisje përmban fluidin ftohës të barabartë me [xxx]. Kjo nënkupton që nëse 1 kg i këtij lëngu ftohës rrjedh në atmosferë. inpakti i ngrohjes globale eshte [xxx] herë më i lartë se 1 kg $CO_2$ për një periudhë 100 vjet. Mos u përpiqni të ndërhyni në qarkun ftohës ose të çmontoni dhe gjithmonë kërkoni një profesionist".

4.2 Gjithashtu, duhet përfshirë informacioni i mëposhtem në skedën informative të kondicionerëve te ajrit për gjendjen e ftohjes. kur efiçenca deklarohet mbi bazen e shkallës stinore të të efiçencës së energjisë (SEER) :

a) SEER dhe klasën e efiçencës së energjisë të modelit (modeli i një njësie ose kombinim i njësive) të përcaktuara në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave në pikat 2 dhe 8 per gjendjen e ftohjes së bashku me kufijtë e klasës të përcaktuar në pikën 7;

b) konsumin vjetor të energjisë elektrike QCE në kWh/vit gjatë stinës së ftohjes. i percaktuar në përputhje me perkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht në pikat 2 dhe 8. Ai duhet përshkruar si: "Konsumi i energjise "XYZ" Kwh për vit. i bazuar në rezultatet e provave standarde. Konsumi aktual i energjisë varet se si pajisja përdoret dhe ku është e vendosur";

c) ngarkesa e projektimit Pproj në KW e pajisjes në gjendjen ftohëse e përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht të dhëna në pikat 2 dhe 8:

4.3 Gjithashtu. përfshihen shënimet e mëposhtme që përcaktojnë informacionin në skedën informative për gjëndjen e ngrohjes kur efiçenca është e deklaruar mbi bazën e koefiçentin stinor të performancës (SCOP):

a) SCOP dhe klasa e efiçencës së energjisë e modelit. ose kombinimi. në gjëndjen e ngrohjes të përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht të dhëna në pikat 2 dhe 8 se bashku me kufijtë e klasës si e përcaktuar në pikën 7:

b) konsumi vjetor i energjisë elektrike për stinën mesatare të ngrohjes QHE në kWh/vit, e përcaktuar në perputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave respektivisht të dhëna në pikat 2 dhe 8. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "XYZ" kWh/në vit, i bazuar në rezultatet e testeve standarde. Konsumi aktual i energjisë varet se si pajisja përdoret dhe ku është e lokalizuar";

c) stinet e tjera të ngrohjes për të cilat njësia është e deklaruar si e përshtatshme për qëllimin e përdorimit, me opsionet e stinëve më të ngrohta ose më të ftohta, si të përcaktuara në pikën 2.

ç) ngarkesa e projektuar Pproj. e pajisjes në gjëndjen e ngrohjes e përcaktuar në perputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave sipas pikave 2 dhe 8.

d) kapaciteti i deklaruar dhe treguesi i rezervës për kapacitetin e ngrohjes së supozuar për llogaritjen e SCOP në referencë të kushteve të projektimit.

4.4 Gjithashtu, shkronjat a), b), c), dhe ç) të kësaj nënpike përcaktojnë informacionin që duhet të përfshihet në skedën informative të kondicionerëve, kur efiçenca është e deklaruar mbi bazën e shkallës së efiçencës së energjisë (EERnom) ose të koeficentit të performancës (COPnom):

a) klasa e efiçencës së energjisë së modelit, e përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe procedurat e proves, të pëcaktuara në pikat 2 dhe 8, së bashku me kufijtë e klasës të përcaktuar në pikën 7.

b) për kondicionerët me dy kalime të ajrit, konsumi në orë i energjisë QDP në kWh/60 minuta i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "X,Y" kWh/ për 60 minuta, i bazuar në rezultatet e provave standarde. Konsumi aktual i energjise varet se si pajisja përdoret dhe ku është e lokalizuar";

c) për kondicioneret me një kalim të ajrit, konsumi në orë i energjisë elektrike QSD në kWh/60 minuta i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8. Ai përshkruhet si: "Konsumi i energjisë "X,Y" kWh/ 60 minuta, i bazuar në rezultatet e provave standarde. Konsumi aktual i energjisë varet se si pajisja përdoret dhe ku është e lokalizuar";

ç) kapaciteti ftohës Pnom në kW i pajisjes i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8.

d) kapaciteti ngrohës Pnom në kW i pajisjes i përcaktuar në përputhje me përkufizimet dhe proçedurat e provave të dhëna në pikat 2 dhe 8.

4.5 Skeda informative mund të përmbajë numrin e modeleve të pajisjes të furnizuar nga i njëjti furnizues.

4.6 Informacioni i përfshirë në skedën informative mund të jepet në formën e një kopje etikete, me ngjyra ose bardhë e zi. Në këtë rast, duhet të sigurohet informacioni i listuar në nëpikat nga 4.

## 5. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik përfshin, së paku. kërkesat e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

b) një përshkrim të përgjithshëm të modelit të pajisjes. i mjaftueshëm për të qënë i qartë dhe lehtësisht i identifikueshëm. Kondicionerët me një kalim të ajrit referohen si "kondicioner lokal"

c) referimet e standardeve të harmonizuar të zbatuara, kur është rasti;

ç) sipas rastit. metodat e llogarijeve të tjera, matjet standardet e matjeve dhe specifikimet e përdorura;

d) identifikimin dhe firmën e personave të autorizuar për t'u lidhur me furnizuesin;

dh) sipas rastit. parametrat teknik të matjeve të kryera në përputhje me pikën 8:

(i) dimensionet e përgjithshme;

(ii) specifikimin e tipit të kondicionerit të ajrit;

(iii) specifikimin nëse pajisja është projektuar vetëm për ftohje ose vetëm për ngrohje apo të dyja bashkë;

(iv) klasën e efiçencës së energjisë të modelit siç përcaktohet në pikën 7;

(v) shkalla e efiçencës së energjisë (EERnom) dhe koefiçentin e performancës (COPnom) për kondicionerët me një dhe dy kalime të ajrit ose shkallën e efiçencës stinore të energjisë (SEER) dhe koefiçentin e performancës stinore (SCOP) për kondicionerët e tjerë;

(vi) Stinën e ngrohjes për të cilën pajisja është e deklaruar e përshtatshme për përdorim;

(vii) nivelet e fuqisë së zhurmës të shprehura në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW, të rumbullakosur në numrin e plotë më te afërt;

(viii) emrin dhe GWP e ftohësit të përdorur.

e) rezultatet e llogaritjeve të kryera në përputhje me pikën 8.

Furnizuesit mund të përfshijnë informacion shtesë në fund të listës së mësipërme.

Kur informacioni i përfshirë në dosjen teknike për një model të veçantë të një kondicioneri është i marrë nga llogaritja mbi bazën e projektimit. ose ekstrapolimit nga pajisje ekuivalente. ose të dyja bashkë. dokumentacioni përfshin detaje të këtyre llogaritjeve ose ekstrapolimeve. ose të dyja bashkë. dhe të testeve të bëra nga furnizuesit për të verifikuar saktësinë e llogaritjeve të ndërmarra. Informacioni përfshin gjithashtu dhe listën e modeleve ekuivalente kur informacioni është i marrë në të njëjtën bazë

## 6. Informacioni që sigurohet në rastet kur përdoruesit e fundit nuk mund të shikojnë shfaqjen e produktit.

6.1 Kondicionerët e ofruar për shitje, qira ose blerje me këste, kur përdoruesi i fundit nuk mund të shikojë produktin, tregtohen nga tregtarët me informacionin e dhënë në pikën 7, së bashku me informacionin sipas renditjes së mëposhtme:

a) klasa e efiçencës së energjisë e modelit, siç përcaktohet në pikën 7;

b) për kondicienerët, përveç kondicionereve me nje dhe dy kalime të ajrit,:

(i) Shkalla e efiçencës stinore të energjisë (SEER) dhe/ose koefiçenti sezonal i performancës;

(ii) ngarkesa e projektuar (në kW);

(iii) konsumi vjetor i elektricitetit;

(iv) stina e ftohtë dhe/ose çdo stinë e ngrohtë (Mesatare, më e ftohtë, më e ngrohtë) që pajisja është e deklaruar që pershtatet për qëllimin përdorimit të saj;

c) për kondicionerët me një dhe dy kalime të ajrit:

(i) shkalla e efiçences së energjisë (EER) dhe/ose koefiçenti i performancës (COP);

(ii) kapaciteti nominal (kW);

(iii) për kondicionerët me dy kalime të ajrit, konsumi në 1 orë i energjisë elektrike për ftohje dhe/ose ngrohje;

(iv) për kondicionerët me nje kalim të ajrit, konsumi në 1 orë i energjisë elektrike për ftohje dhe/ose ngrohje:

ç) nivelet e fuqisë së zhurmës të shprehur në dB(A) kundrejt/referuar 1 pW, rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt:

d) emrin dhe GWP e lëngut ftohës të përdorur.

6.2 Kur jepet një informacion tjeter në skedën informative të produktit, ai të jetë në formën dhe mënyren e specifikuar në pikën 4 .

6.3 Përmasat dhe forma e gërmave për informacionin e referuar në këtë pikë duhet të jetë në Times New Roman minimalisht me gërmat në madhësinë 10 ose minimalisht në një mënyrë të njëvlershme me të.

6.4 Çdo publicitet për një model të veçantë të një kondicioneri të përmbajë klasën e efiçencës së energjisë, nëse publiciteti jep informacion shpjegues lidhur me energjinë ose çmimin. Kur mundësohet më shumë se një klasë e efiçencës, furnizuesi ose prodhuesi deklaron klasën e efiçencës së energjisë të pakten për ngohjen "Mesatare" për stinën e ngrohjes. Informacioni ofrohet, si jepet në pikën 6, në rastet kur përdoruesi i fundit nuk mund të shikojë produktin.

6.5 Çdo material teknik promovues që përmban një model të veçantë të një kondicioneri, material që përshkruan parametra teknikë specifike të tij, duhet të përfshijë klasën e efiçencës së energjisë të modelit si të përshkruar në pikën 7;

## 7. Klasat e efiçencës së energjisë

Efiçenca e energjisë e kondicionerëve të ajrit përcaktohet mbi bazën e matjeve dhe llogaritjeve të dhëna në pikën 8

Si SEER ashtu dhe SCOP marrin parasysh referimin e kushteve të projektimit dhe orët funksionale për mënyrën përkatëse të operimit. SCOP i relatohet stinës së ngrohtë "Mesatare", siç jepet në pikën 8.

Shkalla nominale e efiçensës së energjisë (EERnom) dhe koefiçenti nominal i performancës (COP nom) marrin parasysh kushtet standarde të vlerësimit, siç jepen në pikën 8.

Tabela 1

Klasat e efiçensës së energjisë për kondicionerët e ajrit, përjashtuar ato me nje dhe dy kalime

| Klasa e Efiçencës së Energjisë | SEER | SCOP |
|---|---|---|
| A+++ | SEER ≥ 8,50 | SCOP ≥ 5,10 |
| A++ | 6,10 ≤ SEER < 8,50 | 4,60 ≤ SCOP < 5,10 |
| A+ | 5,60 ≤ SEER < 6,10 | 4,00 ≤ SCOP < 4,60 |
| A | 5,10 ≤ SEER < 5,60 | 3,40 ≤ SCOP < 4,00 |
| B | 4,60 ≤ SEER < 5,10 | 3,10 ≤ SCOP < 3,40 |
| C | 4,10 ≤ SEER < 4,60 | 2,80 ≤ SCOP < 3,10 |
| D | 3,60 ≤ SEER < 4,10 | 2,50 ≤ SCOP < 2,80 |
| E | 3,10 ≤ SEER < 3,60 | 2,20 ≤ SCOP < 2,50 |
| F | 2,60 ≤ SEER < 3,10 | 1,90 ≤ SCOP < 2,20 |
| G | SEER < 2,60 | SCOP < 1,90 |

Tabela 2

Klasat e efiçensës së energjisë për kondicionerët me një dhe dy kalime

| Klasa e efiçencës së Energjisë | Me dy kalime | | Me një kalim | |
|---|---|---|---|---|
| | EERnom | COPnom | EERnom | COPnom |
| A+++ | ≥ 4,10 | ≥4.60 | ≥4.10 | ≥3.60 |
| A++ | 3.60≤EER<4.10 | 4.10≤COP<4,60 | 3.10 ≤EER<3.60 | 2.60≤ COP<3,10 |
| A+ | 3.10≤EER<3,60 | 3.60≤COP<4.10 | 3,10 ≤ EER<3.60 | 2.60 ≤COP<3.10 |
| A | 2.60≤EER<3,10 | 3,10≤COP<3.60 | 2.60 ≤EER<3.10 | 2.30≤COP<2.60 |
| B | 2.40≤EER<2.60 | 2.60≤COP<3.10 | 2.40≤EER<2.60 | 2.00 ≤ COP<2.30 |
| C | 2.10≤EER<2.40 | 2.40≤COP<2.60 | 2.10≤ EER<2.40 | 1.80 ≤ COP <2.00 |
| D | 1.80≤EER<2.10 | 2.00≤COP<2.40 | 1.80 ≤ EER<2.10 | 1.60 ≤ COP <1.80 |
| E | 1.60≤EER<1.80 | 1.80≤COP<2.00 | 1.60 ≤ EER<1.80 | 1.40 ≤ COP <1.60 |
| F | 1.40≤EER<1.60 | 1.60≤COP<1.80 | 1.40 ≤EER<1.60 | 1.20 ≤ COP<1.40 |
| G | < 1.40 | < 1.60 | < 1.40 | < 1.2 |

## 8. Standardet dhe metodat e matjeve dhe llogaritjeve

Informacioni që jepet në etiketë dhe skedën informative duhet të arrihet nëpërmjet proçedurave të besueshme, të sakta dhe të riprodhueshme të matjeve, të cilat marrin parasysh nivelin njohur të zhvillimit shkencor për llogaritjet dhe matjet.

8.1 Për qëllime të pajtueshmërisë dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, matjet dhe llogaritjet bëhen duke përdorur standarde të harmonizuara, numrat referencë të të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare, ose me metoda të tjera të besueshme dhe të riprodhueshme të cilat marrin përgjithësisht parasysh ndryshimet teknollogjike dhe rezultate që konsiderohen si më të sigurta.

8.2 Përcaktimi i konsumit stinor të energjisë, shkalla stinore e efiçencës së energjisë (SEER) dhe koefiçenti stinor i performancës marrin parasysh:

a) kushtet stinore evropiane, të percaktuara në Tabelen 1 të kësaj pike;

b) kushtet referencë të projektimit të përcaktuara në Tabelën 3 të kësaj pike;

c) konsumin e energjisë elektrike për të gjitha gjëndjet e operimit duke përdorur periudhat kohore sipas përcaktimeve në Tabelën 4 të kësaj pike;

ç) efektet e degradimit të efiçensës së energjisë të shkaktuara nga ciklimi on/off (nëse zbatohet) në varësi të tipit të kontrollit të kapacitetit ftohës dhe/ose ngrohës;

d) Korigjimet e koefiçentëve stinore të performancës në kushtet kur ngarkesa e ngrohjes nuk mund të plotësohet nga kapaciteti ngrohës;

dh) Kontributin rezervë të ngrohjes (nëse zbatohet) në llogaritjen e efiçencës stinore të nje njësie në gjëndjen e ngrohjes.

8.3 Kur informacioni i lidhur me një model specifik është një kombinim i njësive të brendshme dhe të jashtme që është marrë nga llogaritja mbi bazën e projektimit dhe/ose ekstrapolimit të kombinimeve të tjera, dokumentacioni përfshin detajime të këtyre llogaritjeve dhe/ose ekstrapolimeve, dhe të provave të kryera për të verifikuar saktësinë e llogaritjeve të kryera (duke përfshirë detajime të modelit matematikor për llogaritjen e performancës të këtyre kombinimeve dhe matjeve të marra për te verifikuar modelin);

8.4 Shkalla e efiçencës së energjisë (EERnom) dhe, kur kërkohet, koeficenti i performancës (COPnom) për kondicionerët me një dhe dy kalime të ajrit përcaktohen në kushtet standarde të vlerësimit siç janë percaktuar në Tabelën 2 të kësaj pike.

8.5 Llogaritja e konsumit të elektricitetit për ftohje dhe/ose ngrohje duhet të marrë parasysh konsumin e energjisë të të gjitha gjëndjeve përkatëse të operimit duke përdorur periudhat kohore siç përcaktohen në Tabelën 4 të kësaj pike.

Tabela 1

Numri bin(j), temperatura e jashtme (Tj) në °C dhe numri i orëve për bin (hj) për stinën e ftohtë dhe për stinët e ngrohta "mesatare", "e ngrohtë" dhe dhe më e ftohtë", db = temperatura në gjendje të thatë

| Stina e ftohtë | | | | | Stina e nxehtë | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Mesatare | E ngrohtë | E freskët |
| j | Tj °C | hj | j | Tj °C | hjA | hj W | hjC |

| | | h | | | h | h | h |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| db | | | | | Db | | |
| 1 | 17 | 205 | 1 to 8 | -30 to–23 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | 18 | 227 | 9 | -22 | 0 | 0 | 1 |
| 3 | 19 | 225 | 10 | -21 | 0 | 0 | 6 |
| 4 | 20 | 225 | 11 | -20 | 0 | 0 | 13 |
| 5 | 21 | 216 | 12 | -19 | 0 | 0 | 17 |
| 6 | 22 | 215 | 13 | -18 | 0 | 0 | 19 |
| 7 | 23 | 218 | 14 | -17 | 0 | 0 | 26 |
| 8 | 24 | 197 | 15 | -16 | 0 | 0 | 39 |
| 9 | 25 | 178 | 16 | -15 | 0 | 0 | 41 |
| 10 | 26 | 158 | 17 | -14 | 0 | 0 | 35 |
| 11 | 27 | 137 | 18 | -13 | 0 | 0 | 52 |
| 12 | 28 | 109 | 19 | -12 | 0 | 0 | 37 |
| 13 | 29 | 88 | 20 | -11 | 0 | 0 | 41 |
| 14 | 30 | 63 | 21 | -10 | 1 | 0 | 43 |
| 15 | 31 | 39 | 22 | -9 | 25 | 0 | 54 |
| 16 | 32 | 31 | 23 | -8 | 23 | 0 | 90 |
| 17 | 33 | 24 | 24 | -7 | 24 | 0 | 125 |
| 18 | 34 | 17 | 25 | -6 | 27 | 0 | 169 |
| 19 | 35 | 13 | 26 | -5 | 68 | 0 | 195 |
| 20 | 36 | 9 | 27 | -4 | 91 | 0 | 278 |
| 21 | 37 | 4 | 28 | -3 | 89 | 0 | 306 |
| 22 | 38 | 3 | 29 | -2 | 165 | 0 | 454 |
| 23 | 39 | 1 | 30 | -1 | 173 | 0 | 385 |
| 24 | 40 | 0 | 31 | 0 | 240 | 0 | 490 |
| | | | 32 | 1 | 280 | 0 | 533 |
| | | | 33 | 2 | 320 | 3 | 380 |
| | | | 34 | 3 | 357 | 22 | 228 |
| | | | 35 | 4 | 356 | 63 | 261 |
| | | | 36 | 5 | 303 | 63 | 279 |
| | | | 37 | 6 | 330 | 175 | 229 |
| | | | 38 | 7 | 326 | 162 | 269 |
| | | | 39 | 8 | 348 | 259 | 233 |
| | | | 40 | 9 | 335 | 360 | 230 |
| | | | 41 | 10 | 315 | 428 | 243 |
| | | | 42 | 11 | 215 | 430 | 191 |
| | | | 43 | 12 | 169 | 503 | 146 |
| | | | 44 | 13 | 151 | 444 | 150 |
| | | | 45 | 14 | 105 | 384 | 97 |
| | | | 46 | 15 | 74 | 294 | 61 |
| Total | | 2602 | | | 4910 | 3590 | 6446 |

Tabela 2

Kushtet standarde të vlerësimit, temperaturat në "gjëndje të thatë" e temperaturës së ajrit ("wet bulb"e treguar në kllapa)

| Pajisja | Funksioni | Temperatura e brendshme e ajrit (°C) | Temperatura e jashtme e ajrit (°C) |
|---|---|---|---|
| Kondicionerët e ajrit, përjashtuart me një kalim | ftohje | 27 (19) | 35 (24) |
| | ngrohje | 20 (max. 15) | 7(6) |

| Me nje kalim | ftohje | 35 (24) | 35 (24) [1] |
|---|---|---|---|
| | ngrohje | 20 (12) | 20 (12) [1] |
| [1] Në rastin e kondicionerëve me një kalim, kondesatori (avulluesi) nuk ushqehet me ajër të brendshëm | | | |

Tabela 3

Referimi i kushteve të projektimit, temperaturat e ajrit në gjëndje të thatë ("gjëndje e thatë" e treguar në kllapa)

| Funksioni/stina | Temperatura e brendshme e ajrit (°C) | Temperatura e jashtme të ajrit (°C) | Temperatura bivalente(°C) | Temperatura kufitare e përdorur (°C) |
|---|---|---|---|---|
| | Tin | Tdesignc/Tdesignh | Tbiv | Tol |
| ftohje | 27 (19) | Tdesignc = 35 (24) | n.a | n.a |
| e nxehtë/e ngrohtë | 20 (15) | Tdesignh = – 10 (– 11) | max. 2 | max. – 7 |
| e nxehtë/e ngrohtë | | Tdesignh = 2 (1) | max. 7 | max. – 15 |
| E nxehtë/ e ftohtë | | Tdesignh = – 22 (– 23) | max. – 7 | max. – 15 |

Tabela 4 Orët operacionale për tipin e pajisjes që përdoret në mënyrën funksionale për llogaritjen e konsumit të energjisë elektrike

| Tipi i pajisjes/funksioni (nëse zbatohet) | Njësia | | Stina e ngrohtë | Ndezur | Termostat i stakuar | Gjendje gadishmëri | Stakuar | Gjendjee operimit bazuar tek ngrohja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ftohje: HCE<br>ngrohje: HHE | HTO | HSB | HOFF | HCK |
| Kondicionere ajri, perjashtuar me nje dhe dy kalime | | | | | | | | |
| Ftohje vetem nese pajisja ofrpon vetem ftohje | h/annum | | | 350 | 221 | 2142 | 5088 | 7760 |
| Ftohje dhe ngrohje nëse pajisja ofron të dy gjendjet | Ftohje | ore/vit | Mesatere Ngrohje | 350<br>1400<br>1400 | 221<br>179<br>755 | 2142<br>0<br>0 | 0<br>0<br>0 | 2672<br>179<br>179 |
| | Ngrohje | ore/vit | Ngrohte Ftohte | 1400<br>2100 | 755<br>131 | 0<br>0 | 0<br>0 | 755<br>131 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| Gjendje e ngrohtë nëse pajisja ofron vetem ngrohje | ore/vit | | Mesatar e Ngrohje Ftohje | 1400<br>1400<br>2100 | 179<br>755<br>131 | 0<br>0<br>0 | 3672<br>4345<br>2189 | 3851<br>3851<br>2944 |
| Kondicioner me dy kalime | | | ftohje HCE<br>ngrohje: HHE | HTO | HSB | HOFF | HCK | |
| Gjendje ftohëse, nëse pajisja ofron vetëm ftohje | h/60 min | | | 1 | n/a | n/a | n/a | n/a |
| Gjendjet ftohëse dhe ngrohëse, nëse pajisja i ofron te dyja. | ore/60 min<br>ore/60 min | | Gjendje ftohëse<br>Gjendje ngrohë | 1<br>1 | n/a<br>n/a | n/a<br>n/a | n/a<br>n/a | n/a<br>n/a |
| Gjendje ngrohese, nese pajisja ofron vetem ngrohje | ore/60 min | | | 1 | n/a | n/a | n/a | n/a |
| kondicioner me një kalim<br>gjendje ftohëse<br>gjendje ngrohëse | orë/60 min<br>orë/60 min | | | ftohje: HCE<br>ngrohje: HHE<br>1<br>1 | n/a<br>n/a | n/a<br>n/a | n/a<br>n/a | n/a<br>n/a |

[*] Ne rastin me nje kalim, kondesatori (avulluesi)t kur ftohja (ngrohja), nuk furnizohet me ajër nga jashtë por me ajër nga brënda.

## 9. Proçedura e verifikimit për qëllime të mbikqyrjes së tregut përfshirë nivelet e lejueshme të saktësisë në deklarimin e etiketës dhe skedës informative

Gjatë kryerjes së kontrolleve të mbikëqyrjes së tregut, struktura përgjegjëse e mbikqyrjes së tregut nën Ministrinë përgjegjëse për tregtinë (me poshtë struktura përgjegjëse) zbaton proçeduren e mëposhtme të verifikimit për vlerësimin e përputhshmërisë së deklarimeve për

klasën e efiçensës së energjisë, konsumin për 1 orë apo vjetor të energjisë si dhe emetimin e zhurmave.

9.1 Struktura përgjegjëse teston vetëm një njësi.

9.2 Modeli i kondicionerit, përjashtuar ato me një dhe dy kalime të ajrit, konsiderohet se përmbush dispozitat e dhëna në pikën 2 në këtë Rregull Teknik, nëse shkalla e tij e efiçencës së energjisë (SEER), ose nëse është e zbatueshme, koeficienti i performancës stinore ( SCOP ), eshte jo më i vogël se vlera e deklaruar minus 8%. Vlerat e SEER dhe SCOP vendosen në përputhje me pikën 7.

Modeli i një kondicioneri me nje dhe dy kalime të ajrit konsiderohen në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pikën 2 nëse rezultatet për gjendjen e stakuar dhe në gjëndjen e lënë ndezur nuk tejkalojnë vlerat kufitare më shumë se 10%. dhe nëse shkalla e efiçensës së energjisë (EERrated), ose kur është i zbatueshëm, koeficienti i performancës (COPrated), , është jo më i vogël se vlera e deklaruar minus 10%. Vlerat EER COP vendosen në përputhje me pikën 7.

Modeli i kondicionerit konsiderohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Rregull Teknik, nëse niveli maksimal i fuqise së zhurmës nuk kalon më shumë se 2 dB (A) vlerën e deklaruar.

9.3 Nëse rezultati i referuar në nenpikën 9.2 nuk plotësohet, struktura përgjegjëse në mënyrë rastësore zgjedh tre modele te tjera të njëjta për testim.

9.4 Modeli i kondicionerit, përjashtuar ato me një dhe dy kalime të ajrit, konsiderohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pikën 2 të këtij Rregulli Teknik, nëse mesatarja e tre njësive për shkallen stinore të efiçencës së energjisë (SEER), ose, nëse zbatohet, koefiçenti stinor i performancës (SCOP), është jo më i vogël se vlera e deklaruar minus 8%. Vlerat e SEER dhe SCOP do të vendosen në përputhje me pikën 7.

Modeli i një kondicioneri me një dhe dy kalime të ajrit konsiderohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pikën 2, të këtij Rregulli Teknik, nëse mesatarja e rezultateve të tre njësive në kushtet e gjëndjes së stakuar dhe në gjendje gadishmërie nuk tejkalojnë më shumë se 10%. vlerat kufi dhe nëse mesatarja e shkallës së efiçensës së energjisë (EERrated), ose koefiçienti i performances (COPrated), nuk është më i vogël se vlera e deklaruar minus 10%.

Vlerat e EER dhe COP do të vendosen në përputhje me pikën 7.

Modeli i kondicionerit konsiderohet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Rregull Teknik, nëse mesatarja e rezultateve të tre njësive për nivelin e fuqisë së zhurmës nuk tejkalon më shumë se 2 dB (A) vlerën e deklaruar.

9.5 Nëse rezultatet e referuara në nëpikën 9.4 nuk janë arritur, modeli konsiderohet jo në përputhje me këtë Rregull Teknik.

Për qëllime të përputhshmërisë dhe verifikimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, Struktura Përgjegjëse zbaton proçedurat e referuara në pikën 7 dhe standardet e harmonizuara shqiptare, numrat referencë të të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, ose në burime të tjera të besueshme të llogaritjes dhe metodave të matjes të sakta

dhe të riprodhueshme të cilat marrin parasysh gjendjen përgjithshme të zhvillimit teknollogjik.

**10. Informacioni që duhet siguruar në rast të shitjes, qerasë ose blerjes me këste nëpërmjet internetit**

10.1 Për qëllim të nënpikave nga 10.2 deri në 10.5 të kësaj pike, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "mekanizëm shfaqës" është çdo ekran, duke përfshirë ekranin e prekshëm, ose teknologji të tjera vizuale të përdorura për të shfaqur përmbajtjen e internetit për përdoruesit:

b) "shfaqje e mbivendosur" është ndërfaqja vizuale ku një pamje apo grup të dhënash shfaqen me një klikim të mausit, mausit rëshqitës ose zgjerim në ekranin e prekshëm të një pamje tjetër apo grup të dhënash;

c) "ekran me prekje" ësht një ekran që i përgjigjet prekjes, të tilla si ajo e një kompjuteri tabletë, kompjuter propozues ose një smartfon (telefon intiligjent);

ç) "tekst alternative" është teksti që ofrohet si një alternativë për një informacion grafik që lejon të prezantohet në formë jo-grafike ku pajisjet shfaqëse nuk mund të përmbajnë grafikë ose si një ndihmese për qasje të tilla si inpute ndaj aplikacioneve të sintezës zanore.

10.2 Etiketa përkatëse e vënë në dispozicion nga furnizuesit, në përputhje me pikën 3 duhet të tregohet në ekran në afërsi të çmimit të produktit, në përputhje me afatet kohore te përcaktuar në nënpikat nga 3.6 deri në 3.8. Madhësia e etiketës duhet të jetë i tillë që të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme dhe në përpjesëtim me madhësinë e specifikuar në nënpikën 3.1. Etiketa mund të shfaqet duke përdorur një shfaqje të mbivendosur, në kete rast pamja që përdoret për të hyrë në etiketë duhet të përputhet me specifikimet e përcaktuara në nënpikën 10.3. Nëse zbatohet shfaqje e mbivendosur , etiketa shfaqet me klikimin e parë te mausit, mauzit rrëshqitës ose me zgjerim të pamjes në ekranin e prekshëm.

10.3 Pamja e përdorur për mundësimin e etiketës në rastin e shfaqjes së mbivendosur duhet:

a) të jetë një shigjetë në ngjyrën që i korrespondon klasës së efiçensës së energjisë së produktit në etiketë:

b) të tregojë mbi shigjetën klasën efiçensës së energjisë së produktit në të bardhë në një madhësi ekuivalente me atë të çmimit: dhe

(c) të ketë një nga dy formatet e mëposhtëm




10.4 Në rastin e shfaqjes së mbivendosur, sekuenca e shfaqjes së etiketës eshte si me poshte:

a) pamja e referuar në nënpikën 10.3 tregohet në ekran në afërsi të çmimit të produktit:
b) pamja lidhet me etiketën;
c) etiketa shfaqet pas një klikimi të mausit, mausit rrëshqitës, ose zgjerimin e pamjes në ekranin me prekje;
ç) etiketa shfaqet në faqen tjetër. skedë të re, faqe të re ose në ekran kuadrat;
d) për zmadhimin e etiketës në ekranet me prekje, zbatohen pajisjet standarde në prekjen për zmadhim;
dh) etiketa pushon se shfaquri me anë të një opsioni mbyllës apo mekanizëm tjetër standart per mbyllje;
e) teksti alternativ për grafik, që shfaqet në dështimin e shfaqjes së etiketës, është klasa e efiçensës së energjisë të produktit në një madhësi ekuivalente me atë të çmimit.

10.5 Skeda përkatëse informative e produktit e bërë e disponueshme nga furnizuesit, në përputhje me pikën 4, duhet të tregohet në ekran në afërsi të çmimit të produktit. Madhësia duhet të jetë e tillë që skeda informative të jetë qartësisht e dukshme dhe e lexueshme. Skeda informative e produktit mund të shfaqet duke përdorur një shfaqje të mbivendosur, në këtë rast lidhja e përdorur për të hyrë në një skedë duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe lexueshme "Skeda e produktit". Nëse është përdorur ekrani i mbivendosur. skeda informative e produktit paraqitet në klikimin e parë te mausit, mausit rrëshqitës ose ekranit me prekje zgjerimin mbi link ".